



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO  
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS  
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

# 20002 RAPORTI VJETOR

# Përmbajtja

Letër e Shefit Ekzekutiv dhe Drejtorit të Përgjithshëm të BPK-së.....	1
<b>Përmbledhje.....</b>	<b>2</b>
<b>Mjedisi Ndërkombëtar.....</b>	<b>3</b>
Ekonomia globale.....	3
Bashkimi Evropian.....	4
Vendet e Ballkanit Perëndimor.....	5
<b>Ekonomia e Kosovës.....</b>	<b>7</b>
Prodhimi Brendshëm Bruto.....	7
Paraja dhe çmimet.....	8
Popullsia.....	10
Ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet.....	11
Konsumi.....	12
Ndërmjetësimi Financiar.....	13
Tregtia e Jashtme dhe Bilanci i Pagesave.....	15
Politika Fiskale.....	18
<b>BPK në vitin 2002.....</b>	<b>20</b>
Struktura dhe Funkcionet.....	20
Struktura organizative.....	20
Mbikëqyrja bankare.....	20
Mbikëqyrja e sigurimeve.....	24
Mbikëqyrja e Fondeve të Pensioneve.....	27
Funkcionet Bankare.....	27
Sistemi i Kliringut Ndërbankar.....	28
Operacionet e Jashtme.....	29
Aktivitetet më të rëndësishme të BPK-së.....	31
Kalimi në valutën euro.....	31
Rrjeti i Filialave të BPK-së.....	32
Zhvillimeve i Burimeve Njerëzore.....	32
Bartja e Përgjegjësisë të Menaxhmentit.....	33
Implementimi i Planit Suplementar të Pensioneve të BPK-së.....	34
<b>Pasqyrat Financiare të BPK-së për vitin 2002.....</b>	<b>35</b>
Informatë e Përgjithshme lidhur me Pasqyrat Financiare.....	35
Raporti i Auditorit të Pavarur.....	37
Bilanci i gjendjes.....	38
Bilanci i suksesit i BPK-së.....	39
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë së Gatshme të BPK-së.....	40
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin e Paguar dhe Rezervat.....	41
Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së.....	42
<b>Rregulloret dhe rregullat e BPK-së.....</b>	<b>54</b>
<b>Shtojcë.....</b>	<b>58</b>
Fjalor i shkurtesave.....	58
Të dhëna statistikore.....	59

## ***I nderuari Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara***

*Më jep kënaqësi të madhe ky prezantimi, para jush, i Raportit Vjetor 2002 të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës. Gjithashtu, publikimi i tij ndodhë në kohën kur po mbushet një vit i plotë i qendrimit tim në Kosovë. E pata vizituar Prishtinën shkurtimisht, në vitin 1999, dhe diku afër tre vite pas asaj më është dhënë rasti që të kthehem në Kosovë dhe të udhëheq me BPK-në. Isha tepër e kënaqur kur pashë të arriturat aq të mëdha dhe ndryshimet e shumta pozitive që kishin zënë vend brenda tre viteve në Kosovë.*

*Vitin 2002 e karakterizuan dy ngjarje kryesore – kalimi në valutën euro dhe dorëzimi bankave komerciale i rrjetit të filialave të BPK-së.*

*Së pari, jam krenare për të dëshmuar angazhimin e mrekullueshëm të krejtë personelit të BPK-së rreth sigurimit që kalimi në valutën euro ishte bërë pa telashe dhe në kohë në Kosovë. Përgatitjet e thella për këtë kalim patën startuar në fillim të vitit 2001 dhe kërkuan organizim dhe planifikim të konsiderueshëm.*

*Së dyti, jam në pozitë që të bëjë publike se, në vijë me objektivin e BPK-së për shuarjen e involvimit të saj në aktivitetet bankare komerciale - atëherë kur sektori financiar të jetë i zhvilluar në masë të mjaftueshme në Kosovë, BPK-ja, në korrik të vitit 2002, shpërndau rrjetin e saj të filialave të përbërë nga gjashtë filiala dhe 15 në-filiala duke ua lënë këtë në përkujdesje bankave komerciale. Ky objektivi u arrit pa humbje të vendeve të punës. Sidoqoftë, shërbimet komerciale, kryesisht në mbështetje të AQF-së dhe funksioneve të UNMIK-ut, vazhduan të ofrohen përmes Filialës së BPK-së në Prishtinë.*

*Struktura e re organizative, e zhvilluar me asistencën e FMN-së, u implementua në shtator të vitit 2002. Kjo u bë për të mbështetur përgjegjësitë e reja të BPK-së, në vitin 2003, si një bankierë dhe agjent fiskal i Administratës së pranuar të Kosovës, të përfaqësuar nga Institucionet e Vetë Qeverisjes së Përkohshme (IVP). Pas kësaj, BPK-ja do të funksionojë efektivisht si bankë qendrore e Kosovës. Struktura e re definon përgjegjësitë e zëvendës menaxherëve vendor në funksionimin e përditshëm dhe, efektivisht nga 1 janari 2003, roli i Ekspertëve Ndërkombëtar në BPK do të ndryshojë në atë të Këshilltarëve, të cilët do të vazhdojnë të mbështesin dhe zhvillojnë më tutje lëmitë funksionale relevante.*

*Në vitin 2002, trajnimeve iu dha prioritet i lartë, ndërsa vazhdojnë programet për përmirësimin e aftësive profesionale e menaxhuese të personeli të BPK-së. Përkundër progresit të madh, të arritur në këtë lëmi, edhe shumë mbetet për tu bërë.*

*Kam kënaqësinë që t'ua paraqes Raportin Vjetor për vitin 2002 të Autoriteti Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.*

*Chaiha Kim Rhee  
Drejtor i Përgjithshëm*

*Prishtinë, Prill 2003*

## Përmbledhje

Përkundër ngadalsimit ekonomik global, i filluar në vitin 2001 dhe vazhduar në atë 2002, ekonomitë e shteteve të regjionit të Ballkanit, anipse shkallët e rritjes ishin më të ulta së para dy viteve, vazhduan me rritjen. Bazuar në rritjen e PBB-së në vitin 2002, Kosova e ruajti pozitën e saj udhëheqëse në regjion duke arritur një shkallë të rritjes së PBB-së prej 7%. Përkundër kësaj, niveli i të ardhurave është ende ndër më i ulët në Evropë. PBB-ja për kokë banori, në vitin 2002, është vlersuar të jetë rreth 1,000 \$ dhe kjo është vazhdimisht nën nivelet e shënuara në shtetet tjera të pas konfliktit në regjion.

Rritja ekonomike është ende e udhëhequr kryesisht nga asistenca e huaj dhe dërgesat nga diaspora kosovare. Në pritje të rënies së asistencës së donatorëve dhe dërgesave private – të cilat janë të ndieshme ndaj klimës ekonomike globale, shtrohet nevoja urgjente për një strategji gjithëpërfshirëse zhvillimore për transformimin e ekonomisë kosovare të varur nga ndihmat në atë që njihet si rritje e qendrueshme. Shkalla e paunësisë e vlersuar në 50% vazhdon të jetë ndër më të lartat në regjion.

Rritjet e theksuara fillestare të çmimeve, në shkallë vjetore dyshifrore, vazhduan me një stabilizim gradual të çmimeve në vitet 2001-2002. Krahasuar me vitin paraprak, çmimet e mallrave dhe shërbimeve konsumuese, në korrik të vitit 2002, ishin për 1.4% më të larta. Sidoqoftë, këto çmime, në dhjetor të 2002-ës, ishin diç më të ulta se sa në dhjetor të 2001-ës. Shkalla mesatare e çmimeve të konsumit, në vitin 2002, ishte për 3.6% më e lartë se në vitin 2001. Si pasojë e kapacitetit të kufizuar të shpenzimit dhe të hyrave plotësuese nga aplikimi i tatimit të ri personal, shkalla e suficitit të përgjithshëm të buxhetit të konsoliduar (përfshirë grantet buxhetore) u rrit nga 41.7 milionë euro (2001) në 68.7 milionë euro (2002).

Vitin 2002 e veqoi kalimi i gjerë evropian prej valutave lokale në valutën euro. Përdorimi i DEM-it në Kosovë që zyrtarizuar në vitin 1999 dhe më tutje, në të njëjtën kohë me shtetet tjera participuese në BE, që marrë vendimi për ndërrimin e saj me euro. Edhe pse parimi i kalimit në euro ishte i thjeshtë, shkalla dhe aspektet teknike të këtij operacioni diktuan nevojën për kyqjen e shumë agjencioneve qeveritare, KFOR-it dhe ndërmarrjeve komerciale. Përgatitjet në Kosovë për kalim në euro patën filluar në gushtin e 2000-ës. Objektivi kryesor i BPK-së dhe i UNMIK-ut ishte që të sigurohej një kalim sa më i lehtë e i sigurtë dhe me kosto mundësisht sa më të ultë. Kalimi në valutën euro solli një shansë unike për reduktimin e sasisë së parasë së gatshme në qarkullim, ndërsa me inkurajimin e lëvizjes prej një sistemi të bazuar në pagesa me të gatshme kah ai me jo të gatshme, ndikoi në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit bankar.

Tre vitet e fundit dëshmojnë për një zhvillim rapid të sektorit financiar në Kosovë, veçmas atij bankar. Këtë, më së miri, e ilustron numri i rritur i njësive bankare nga 5 (dhjetor 2000) në 112 (dhjetor 2002) si dhe rritja e numrit dhe vlerës së transakcioneve ndërbankare midis vitit 2001 dhe 2002. Sektori financiar në Kosovë, në vitin 2002, arriti shkallë të mjaftueshme zhvillimi, kështuqë BPK-ja, si pjesë të përkujdesjes vijuese ndaj bankave komerciale, pati mundësi të shpërndajë rrjetin e sa të filialave (6 filiala dhe 15 nën-filiala) duke ua dhënë në lizing bankave komerciale. Pra, BPK-ja pushoi së ushtruarit të aktiviteteve bankare komerciale. Një strukturë e re organizative e BPK-së u jetësua në shtator të vitit 2002. Kjo u bë me qëllim të mbështetjes së përgjegjësive të reja të BPK-së si bankierë dhe agjent fiscal i Administratës së pranuar të Kosovës, të përfaqësuar nga ana e Institucioneve të Vetë Qeverisjes së Përkohshme (IVP). BPK-ja është në rrugë të kalimit gradual e cila shpie efektivisht kah funksionet dhe përgjegjësitë e saj të supozuara për bankën qendrore të Kosovës.

Në vitin 2002, trajnimeve iu dha prioritet i lartë, ndërsa vazhdojnë programet për përmirësimin e aftësive profesionale e menaxhuese të personeli të BPK-së. Është arritur progress i madh në këtë lëmi.

# Mjedisi ndërkombëtar

## Ekonomia globale

Zhvillimi i ngadalshëm i ekonomisë globale i filluar në vitin 2001 vazhdoi edhe në vitin 2002. Ringjallja e dobët ekonomike, në radhë të parë, rrodhi nga rrethina gjeopolitike e pasigurtë, pastaj sektori i dobët korporativ, rënia e tregut të aksioneve si dhe ngritja e çmimeve të naftës.

Pas rënies së konsiderueshme të aktivitetit ekonomik, në tremujorin e fundit të vitit 2001, pritej të pasonte rritje më dinamike globale. Megjithatë, ringjallja e parashikuar, që filloi në çerekun e parë të vitit 2002, dështoi në përsheptimin e saj kështuqë rritja në vendet e OECD-së ra prej 0,7% sa ishte në çerekun e parë të 2002-ës, në 0,4% në çerekun e dytë. Vlerësimet e para për tërë vitin 2002 tregojnë rritje vjetore të PBB-së në vendet e OECD-së për 1.2%. Indikatorët kryesorë, tash vonë të llogaritur nga OECD-ja, tregojnë vazhdim të rritjes së dobët në vitin 2003. Si në rastin e çdo ngecjeje, vendet në zhvillim, veçanërisht ato të varura nga eksporti i mallrave, ishin më së tepërmi të goditura. Në kohën kur çmimet e naftës u ngritën dhe kur shumë çmime të mallrave shënuan rënie historike, investuesit privat reduktuan ekspozimin e tyre në ekonominë në zhvillim, veçanërisht në ato që janë jashtëzakonisht të ngarkuara me borxhe. Ngjashëm pësuan edhe vendet me varshmëri të madhe ndaj teknologjisë së lartë dhe turizmi. Është pritur që përmirësimet në tregjet e kapitalit, duke pasur parasysh vonesën në efektin e tyre negativ në mirëqenie, do të ndikojnë më tutje në tashmë keqësimin e shpenzimeve investive në vitin 2003.

Politika e SHBA-së që nxiti ringjalljen ekonomike, e rezultuar nga humbja e politikës monetare, shpjeu deri te ringjallja e tregtisë ndërkombëtare në katër muajtë e parë të vitit 2002. Vlerat e tregtisë ndërkombëtare janë zvogëluar që nga fundi i vitit 2000 dhe ringjallja ekonomike e SHBA-ve rezultoi në kthimin e përkohshëm të këtij trendi. Pas rritjes së fuqishme në fillim të vitit 2002, vlera mujore tregtare, në maj të vitit 2002, ka rënë nën nivelin e fundvitit 2001.

Rritjet vjetore të PBB-së, për vitin 2002, janë pritur të jenë rreth 1.2% në SHBA dhe vetëm 0.9% në BE. Rritja ekonomike në SHBA ka qenë, në radhë të parë, rezultat i shpenzimeve qeveritare dhe investimeve private. Ekspansioni i nxitur nga importet dhe eksporti i dobët ka rezultuar në zgjerimin e deficitit tregtar. Pas një periudhe të gjatë të inflacionit të ulët dhe politikës së dollarit të fortë, presionet inflatore u rishfaqën në ekonominë e SHBA-së. IÇK-të e raportuar në tetor (2%) dhe nëntor (2.2%) qenë në nivelet më të larta për një periudhë një vjeçare. Përkundër vazhdimin të shfrytëzimit të ultë të kapaciteteve, poashtu për here të parë, IÇP-ja në sektorin e prodhimit është rritur gjatë një periudhe 12 mujore.

Ringjallja ekonomike në rajonet tjera nuk ishte e njëjtë. Në mesin e kombeve të G-7, Kanada ishte ekonomia me performansë më të mirë, ndërsa Australia dhe Zelanda e Re patën normë më të lartë të rritjes se pjesa tjetër e botës. Azia shënoi norma të fuqishme dhe të përsheptuara të rritjes, me Kinën, Malajzinë dhe Korenë, duke përfutur veçanërisht nga investimet në sektorin publik dhe rritja e eksporteve. Pas viteve të performansës së dobët, madje edhe Japonia, si duket, po del nga recesioni. Në mesin e ekonomive të tregut në zhvillim, vendet e akcesionit në BE treguan rritje të vazhdueshme për dallim nga rënia në vendet tjera të BE-së. Ngjashëm me këtë ishte edhe në Rusi ku u arritën rezultate të kënaqshme. Amerika Latine, në vitin 2002, pësoi kthim prapa të ekonomisë. Kriza e prolonguar ekonomike në Argjentinë u përhap në vendet tjera të rajonit, ndërsa dështimi i sektorit bankar shkaktoi trazira financiare në Uruguaj, Paraguaj dhe Brazil. Poashtu, efekti kompleks i jostabilitetit politik në Brazil dhe Venecuelë shtoi problemet ekonomike edhe ashtu ekzistuese. Kjo rezultoi me një rënie të PBB-së të vlerësuar prej 1%, në vitin 2002, në Amerikën Latine. Meksiko dhe Kili ishin vendet me performansë më të mirë në rajon.

## Bashkimi Evropian

Me paraqitjen e suksesshme të euro bankënotave dhe monedhave, viti 2002, filloi me një trend pozitiv në eurozonë. Euro vazhdon të jetë faktor pozitiv i integritit dhe reformës ekonomike si dhe siguron bazë për rritje dhe stabilitet të qëndrueshëm. Stabiliteti relativ i kursit të këmbimit të euros karshi dollarit, poashtu sugjeron se shumica e ekonomive të vendeve industriale qenë të prekura deri në një shkallë të njëjtë.

Pëkundër turbulencës financiare trevjeçare, midis viteve 1998-2000, në Azinë Lindore, në Rusi dhe në Brazil dhe goditjeve negative të tregut që pasuan, euro-zona, gjatë kësaj periudhe, shënoi norma të rritjes ekonomike mesatarisht më tepër se 3%. Në kundërshtim me supozimin se euro-zona, si ekonomi e madhe dhe relativisht e mbyllur, do të jetë e qëndrueshme ndaj goditjeve të jashtme, rritja e fuqishme nuk mundi të qendroi derisa ambienti i jashtëm keqësohej. Investimet vazhduan të zvogëlohen, konsumi privat në euro-zonë ishte i dobët, ndërsa rritja e pasigurisë parandaloi arritjet premtuese në tregtinë ndërkombëtare si nxitëse e kërkesës së brendshme. Rritja e kërkesës së brendshme në rajon filloi të zvogëlohet kah mesi i vitit 2000 dhe, duke u bërë përkohësisht negative në vitin 2001, dha kontribut të dobët në rritjen e PBB-së në vitin 2002.

Ekonomia e euro zonës shënoi tre cikle kryesore të ngjashme për tri dekadat e kaluara: më 1974, 1980 dhe 1992. Edhe pse në kuptimin teknik, rënia e tanishme nuk është kualifikuar si recesion, ashpërsia e saj është e krahasueshme me rëniet paraprake. Poashtu, kjo veçohet me një tipar të pazakontë të një rënie pothuajse të njëkohshme të të gjitha komponenteve të kërkesës së brendshme dhe të tregtisë botërore. Pavarësisht nga kjo, ambienti i përgjithshëm aktual ekonomik duket më pozitiv se në ciklet e mëparshme. Deficitet buxhetore janë në nivele dukshëm më të ulëta (mesatarja dyvjeçare pas pikës më të lartë të ciklit: 1975/76- 3.7%, 1981/82 – 5.2%, 1993/94 –5.3% dhe 2001/02 –1.9% e PBB-së) dhe rritja e punësimit në euro-zonë ka qenë pozitive me rritjen vetëm marginale të papunësisë (mesatarja dyvjeçare pas pikës më të lartë të ciklit; 1975/76- 4.1%, 1981/82-7.4%, 1993/94-10.5% dhe 2001/02 – 8.1%).

Pas dy vitesh të rritjes së dobët (rritja reale e PBB-së, për vitin 2002, është vlerësuar të jetë 0.9 për qind, ndërsa në vitin 2001 ishte 1.5 %), pritet që edhe viti i tretë i rritjes në eurozonë të jetë i dobët. Anë specifike e këtij ngadalsimi është ajo se inflacioni sipas çmimeve të konsumit nuk tregoi shenja keqësimi. Që nga pranvera e vitit 2002, inflacioni i IHÇK-së (Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit) ishte afër caktimit më të lartë të limituar nga ana e BQE-së në 2 %, ndërsa inflacioni bazë mbeti vazhdimisht i lartë afër 2.5%. Lëvizja në çmimet e naftës dhe derivatet e saj, pastaj depreciacioni i vazhdueshëm i kursit këmbimor të euros si dhe rritja e papritur e çmimeve të ushqimit ishin faktorët kryesorë prapa rritjeve të inflacionit në periudhën 2001-2002. Nëse i lëmë anash këta faktorë, del se inflacioni ishte pothuajse i paprekur nga rënia ekonomike. Inflacioni bazë është zvogëluar vetëm gradualisht dhe qëndrueshmëria e tij, veçanërisht në sektorin e shërbimeve, është bërë burim për brengosje. Marrë parasysh se shërbimet janë përbërësi i vetëm dhe më i rëndësishëm i shportës së IHÇK-së në euro-zonë (me një peshë rreth 40%), trendi rritës i inflacionit të tyre bëri presion rritës në inflacionin bazë të euro-zonës dhe ngadalsoi reduktimin e inflacionit kryesor. Ndoshta edhe kalimi në valutën euro, i cili komplikoi krahasimet me çmimet nga e kaluara dhe inkurajoi disa furnizues për t'i ngritur çmimet, mund të ketë kontribuar në perceptimin e përkohshëm jashtëzakonisht negativ të inflacionit. Edhe pse të dhënat zyrtare në dispozicion ende nuk tregojnë ndonjë ndikim të tërësishëm të theksuar në çmime, prej kalimit në euro e deri tash, ndikimi i vlerësuar për regjionin nga ana e Eurostat-it mund të jetë rreth 0.0-0.2%.

Sidoqoftë, implementimi i euros ka eliminuar keqësimet nga lëvizjet në normën e këmbimit dhe të kamatës midis shteteve anëtare të euro zonës me nivelet në normat reale afatshkurtëra dhe afatgjata të kamatave (mesatarja për dy vite pas pikës kulmore të ciklit: 1975/76-nuk ka të dhëna, 1981/82- 2.9% dhe 2.9%, 1993/94-3.9% dhe 4.0% dhe 2001/02- 1,5% dhe 2.6%) të cilat nxisin investimet.

## Vendet e Ballkanit Perëndimor

Regjioni i Ballkanit Perëndimor përbëhet nga ekonomitë relativisht të vogëla si Shqipëria, Bosna e Hercegovina (BeH), Kroacia, Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ), ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM) dhe Kosova. Ekonomia më e madhe me PBB-në me më tepër se €22 miliardë është ajo e Kroacisë, kurse sa i përket popullatës, Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) me 8.6 milionë banorë, është më e madhja.

Derisa popullata e tërë regjionit me gati 25 milion njerëz është baraz me 6.5% të popullatës së BE-së, PBB-ja me rreth €50 miliardë arrinë në përafërsisht 0,6% të gjithëj PBB-së së BE-së. PBB-ja për kokë banori në regjion, në shumë rreth €1.800, tregon ekzistimin e dallimeve të theksueshme midis këtyre vendeve. Kroacia, krahasuar me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ka PBB-në më të lartë për kokë banori, rreth €5.100.

Përkundër rënies në ekonominë botërore dhe nisur nga ringjallja e vitit 2000, regjioni i Ballkanit Perëndimor, në vitin 2001, vazhdoi të rritet me një normë prej 4%. Sidoqoftë, normat e rritjes në shtetet e këtij regjioni pasqyruan dallime të theksuara si në rastin e Kosovës e cila arriti normën më të lartë të rritjes reale të PBB-së për 11%. Shqipëria (+6.5%) dhe RFJ (+5.5%) gjithashtu shënuan progres, ndërsa ekonomia e IRJM-së, matur me PBB-në, shënoi rënie për 4.1%.

Stabilizimi politik dhe procesi i reformave në regjion patën efekt pozitiv në performansën ekonomike të vendeve të këtij regjioni. Vlerësimet e para për vitin e plotë flasin për një rritje vjetore reale të PBB-së diku afër 4%, në vitin 2002

	Popullsia* milione	Rritja reale e PBB-së %		Inflacioni (fondi i periudhës) %	
		2001	2002*	2001	2002*
Shqipëria	3.4	6.5	5.0	3.5	3.9
BeH	4.3	2.3	2.5	3.3	2.3
Kroacia	4.4	3.8	4.0	2.6	3.0
RFJ	8.6	5.5	4.0	39.0	15.0
Kosova	1.8	11.1	7.0	11.6	3.6
IRJM	2.0	-4.1	0.5	3.7	3.0
<b>Ballkani Perëndimor</b>	<b>24.5</b>	<b>4.1</b>	<b>3.8</b>	<b>12.0</b>	<b>6.1</b>

\*Shënime të fundit në dispozicion ose vlerësimet dhe parashikimet e Komisionit Evropian  
Burimi: Burimet vendore, FMN-ja dhe Komisioni Evropian

Regjioni i Ballkanit Perëndimor, krahasuar me ekonominë botërore, vazhdoi të rritet me një hap më të shpejtë në vitin 2001 dhe 2002, ndërsa edhe inflacioni shënoi rënie të vazhdueshme. Gjatë katër viteve të kaluara, Shqipëria, Bosna e Hercegovina, Kroacia dhe IRJM-ja arritën të mbajnë norma njëshifrore të inflacionit. Norma mesatare e inflacionit në këto katër shtete, në fund të vitit 2001, ka qenë e barabartë me 2.9%. Inflacioni për regjionin në tërësi është vlerësuar të ketë zbritur deri në 6%, krahasuar me 12% në vitin 2001, duke arritur kështu një normë njëshifrore, për herë të parë, brenda 15 viteve. Normën e përgjithshme të inflacionit, për tërë regjionin, e keqësoi inflacioni relativisht i lartë prej 39% i shënuar, në fund të vitit 2001, në RFJ, por i cili prap se prap paraqet rënie nga norma prej 113% e shënuar në vitin 2000.

Në vitin 2001, vetëm RFJ dhe Kosova arritën që, duke shënuar deficit të përgjithshëm fiskal (para granteve) prej 1.3% të PBB-së dhe një tepëri prej 1.3% kur përjashtojmë shpenzimet kapitale, t'u

shmangën deficiteve të larta fiskale. Në vendet tjera të regjionit, deficitet e përgjithshme të qeverisë në raport me PBB-në kanë arritur një mesatare për 6% më të lartë se në periudhën e njëjtë. Vlerësimet e para tregojnë se, në vitin 2002, vendet e regjionit të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të RFJ-së, kanë vazhduar të reduktojnë deficitet e tyre fiskale.

Përderisa në njërin anë, deficitet tregtare në raport me PBB-në vazhdojnë të jenë të larta, duke u sjellur zakonisht prej 12% në IRJM (viti 2001) e deri në 50% në Kosovë (viti 2002), ndërsa importet vazhdimisht tejkalojnë rritjet e eksporteve, në anën tjetër, dërgesat private sinjifikante, balanset pozitive të shërbimeve dhe transfertat ofiçiel kanë kontribuar në kufizimin e deficiteve të llogarisë korente.

Kryesisht, BE-ja është dhe mbetet partneri kryesor i tregtisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pjesëmarrja e BE-së në tregtinë totale të tërë regjionit ishte gati mbi 50%, duke filluar nga pjesëmarrja me Shqipërinë rreth 80% e deri ke ajo me RFJ-në prej më shumë se 40%. Bazuar në të dhënat disponuese fillestare, deficitet tregtare, në vitin 2002, nuk janë përmirësuar substancialisht.

Përmirësimi i mëtejshëm i klimës ekonomike në regjion, lufta kundër korrupsionit, përfundimi i procesit të privatizimit dhe reforma në sektorin publik janë të domosdoshme për përmirësimin e performansës së ekonomive të Ballkanit Perëndimor.

# Ekonomia e Kosovës

## Prodhimi Brendshëm Bruto

Ekonomia e Kosovës së paskonfliktit po shënon rritje të lartë të PBB-së, por ajo që brengos ka të bëjë me shkallën e të hyrave që është ndër më të ultat në Evropë. I vlerësuar në rreth \$1,000, PBB-ja për kokë banori, në vitin 2002, është dukshëm nën shkallët e shënuara në shtetet tjera të paskonfliktit në regjion. Bazuar në Hulumtimin mbi Matjen e Standardit Jetësor, të kryer në vjeshtë të vitit 2000, nga ana e Bankës Botërore, Kosova po ballafaqohet me varfëri të gjerë, por jo edhe shumë të thellë. E vlerësuar në 50%, norma e papunësisë vazhdon të jetë ndër më të lartat në regjion.

### Kosova: Tregues të zgjedhur të rritjes ekonomike, milionë euro

	2000	2001	2002
<b>Asistenca e huaj (AH)</b>	<b>1,336</b>	<b>1,290</b>	<b>1,032</b>
PIP (Programi i Investimeve Publike)	628	551	411
Mbështetje buxhetit	102	60	10
Tjera	606	679	611
<b>Importet të ndërlidhura me donatorët</b>	<b>1,268</b>	<b>1,275</b>	<b>1,014</b>
<b>Kontributi i drejtpërdrejtë</b>	<b>356</b>	<b>388</b>	<b>337</b>
AH minus importet të ndërlidhura me donatorët	68	15	18
Konsumi i jorezidentëve (plus të huajtë të ndërlidhur me këtë)	111	210	187
Pagat e të punësuarëve vendorë	177	163	132
<b>Kërkesa e brendshme neto</b>	<b>1,057</b>	<b>1,359</b>	<b>1,653</b>
<b>Konsumi privat</b>	<b>1,411</b>	<b>1,559</b>	<b>1,802</b>
<b>Konsumi qeveritar</b>	<b>152</b>	<b>187</b>	<b>273</b>
<b>Investimi privat</b>	<b>337</b>	<b>397</b>	<b>460</b>
<b>Importet</b>	<b>783</b>	<b>775</b>	<b>962</b>
<b>Faktori korigjues</b>	<b>-61</b>	<b>-9</b>	<b>81</b>
<b>PBB</b>	<b>1,413</b>	<b>1,747</b>	<b>1,990</b>
Deflatori i PBB-së	100.0	11.3	118.5
Norma e inflacionit		11.3	6.5
Në çmime konstante			
<b>PBB</b>	<b>1,413</b>	<b>1,570</b>	<b>1,679</b>
<b>Kërkesa e brendshme neto</b>	<b>1,057</b>	<b>1,221</b>	<b>1,394</b>
<b>Kërkesa neto e gjeneruar nga donatorët</b>	<b>356</b>	<b>349</b>	<b>285</b>
Rritja reale (%)			
<b>PBB</b>		11.1	7.0
<b>Kërkesa e brendshme neto</b>		15.5	14.2
<b>Kërkesa neto e gjeneruar nga donatorët</b>		-2.1	-18.4
Kontributi në rritjen e PBB-së (%)			
<b>PBB</b>		11.1	7.0
<b>Kërkesa e brendshme neto</b>		11.6	11.1
<b>Kërkesa neto e gjeneruar nga donatorët</b>		-0.5	-4.1
<b>PNB (PBB+Neto të hyrat faktoriale+dërgesat e punëtorëve)</b>	<b>2,063</b>	<b>2,434</b>	<b>2,648</b>

Burimi: Vlersime\* / projeksione të stafit të FMN-së

Rritja e fundit e fortë ekonomike, kryesisht ende, është e edhëhequr nga asistenca e lartë e huaj (rreth 50% e PBB-së) dhe dërgesat e diasporës kosovare (rreth 30% e PBB-së). Mirëpo, me zvogëlimin, prej viti në vit, të transfertave të donatorëve për Kosovën, shtrohet nevoja urgjente për një strategji gjithëpërfshirëse zhvillimore e cila do të mundësonte kalimin prej ekonomisë së varur nga ndihmat në atë çfarë e cilëson një zhvillim i qendrueshëm. Për arritjen e këtij objekti afatgjatë lypset jetësim i një programi ekonomik të arsyeshëm dhe koordinim shumë më i mirë ndërsektorial midis të gjithë përbërësve të ekonomisë së Kosovës.

Bazuar në vlerësimet e zyrtarëve të FMN-së<sup>1</sup> dhe rezultatet në dispozicion për vitin 2002, rritja ekonomike u ngadalsua në 7% si rezultat i zvogëlimit të asistencës së huaj dhe aktivitetit ekonomik ende të dobët (posaçërisht sektori i prodhimit). Si pasojë e kësaj, Kosova ndeshet me kontribut rënës, në rritjen e PBB-së, si të kërkesës së gjeneruar nga donatorët ashtu edhe të eksporteve vazhdimisht simbolike të mallrave e shërbimeve.

Prodhimi Nacional Bruto (PNB)<sup>2</sup>, në vitin 2002, ishte më i lartë se PBB-ja për 658 milion euro, ndërsa si konsumi ashtu edhe investimet shënuan rënie të pjesëmarrjes së tyre në PBB. Krahasuar me vitin paraprak, pjesëmarrja e gjithsej importeve në PBB, në fund të vitit 2002, shënon rënie nga 117% në 99%. Me përjashtim të ringjalljes ekonomike të udhëhequr nga financimi i donatorëve në rindërtimin e ndërtesave dhe të infrastrukturës, përmirësimi i ekonomisë së Kosovës ishte i ngadalshëm për shkak të privatizimit të vonuar dhe sektorit privat statik, i cili kryesisht është i involvuar në tregti dhe shërbime me pakicë, pastaj në një nivel të kufizuar të procesimit të prodhimeve bujqësore, prodhimit të pjesëve për makina dhe prodhimit të pijeve. Si pasojë e mungesës së progresit në industri, Kosova vazhdon të jetë e mbështetur për së tepërmi në importe dhe asistencë të huaj.

## Paraja dhe çmimet

Krahasuar me fundin e vitit 2000, paraja gjithsej, në fund të vitit 2002, u rrit për 37.6% dhe atë si rrjedhojë e ndryshimit në portofolio (në fund të vitit 2001) prej parasë në qarkullim në depozitë të ndërmarrjeve dhe të individëve. Kjo rritje impulsive e katërfishtë e depozitave, brenda periudhës njëvjeçare (2001), udhëheqej si nga zhvillimi rapid i sistemit bankar ashtu edhe nga procesi i kalimit në valutën euro. Nivelin stabil i depozitave, gjatë vitit 2002, konfirmon përmirësimin e besimit në sistemin bankar.

Përkundër rrezikut sinjifikant afarist ende ekzistues në Kosovë, kreditimi i sektorit privat nga ana e bankave tregon një trend pozitiv. Pjesëmarrja e kredive dhënë sektorit privat në gjithsej aktivitetet e bankave komerciale, në vitin 2000, ishte vetëm 3.8%, por në vitin 2001 kjo u rrit në 8.3%. Më tutje, kjo pjesëmarrje, në vitin 2002, u rrit në 25.6%. Sidoqoftë, aktiviteti kreditor në tërësi mbetet i limituar (diku rreth 20% e depozitave) duke pasqyruar maturitetin e kufizuar në dispozicion (kryesisht nën një vit) dhe deri diku normat e larta të kamatës. Gjithashtu, pjesëmarrja e këtyre kredive në PBB është ende shumë e ultë dhe në vitin 2002 ishte vetëm 4.2%.

Kosova vazhdon të jetë në një pozitë tepër jo të zakonshme sa i përket aktiveve të brendshme neto<sup>3</sup>. Në Kosovë, krediti i brendshëm është vazhdimisht negativ (175 milionë euro, në fund të vitit 2002).

<sup>1</sup> Vlerësimet për vitet e kaluara dhe parashikimi afatmesëm i bërë nga Misioni i FMN-së (shtator 2002) aktualisht janë në procesin e rishqyrtimit nga ana e Misionit të FMN-së (mars 2003). Misioni i fundit gjeti më shumë të dhëna të besueshme dhe analitike, posaçërisht në lidhje me asistencën e huaj dhe shkallën e importeve në Kosovë. Për këtë arsye, priten ndryshime të konsiderueshme në treguesit makroekonomik të Kosovës.

<sup>2</sup> Prodhimi Nacional Bruto (PNB) = PBB + të ardhurat nga puna e kosovarëve të punësuar nga ana e donatorëve ndërkombëtar në Kosovë + dërgesat e kosovarëve të punësuar jashtë Kosovës.

<sup>3</sup> Shuma e pretendimeve neto ndaj Qeverisë (përfshirë llogaritë depozituese të UNMIK-ut) dhe pretendimeve ndaj ekonomisë së brendshme.

Kjo vie si rezultat i drejtpërdrejtë i politikës fiskale të kujdeshme dhe faktit se BPK-ja nuk emeton paranë si dhe nuk është e autorizuar të jap kredi. Si pasojë e kësaj, BPK-ja nuk mund të ushtrojë politikë klasike monetare e kreditore. Në fakt, implementimi i euros ishte një zgjedhje e politikës monetare.

#### Kosovë: Pasqyra Monetare, mijëra euro

Përshkrimi	2000	2001	2002
	Dhjetor	Dhjetor	Dhjetor
<b>Aktivet e huaja (Neto)</b>	<b>678,101</b>	<b>958,678</b>	<b>1,109,623</b>
Paraja në qarkullim*	536,229	366,578	441,130
BPK	61,697	296,051	345,589
Aktivet	61,697	296,235	345,773
Pasivet	0	184	184
Bankat komerciale	80,175	296,050	322,904
Aktivet	83,099	301,095	328,322
Pasivet	2,924	5,045	5,418
<b>Aktivet e brendshme (Neto)</b>	<b>-52,612</b>	<b>-109,760</b>	<b>-248,683</b>
Pretendimet ndaj Qeverisë (Neto)	-8,741	-72,066	-258,917
Pretendimet	0	0	0
Depozita	8,741	72,066	258,917
Pretendimet ndaj sektorit tjetër publik (Neto)	-32,378	-10,885	-4,245
Pretendimet ndaj institucioneve financiare (Neto)	0	-11,087	-24,619
Kredi sektorit privat	3,148	25,135	83,976
Zëra të tjerë (Neto)	-14,642	-40,857	-44,878
BPK	-4,826	-28,109	-11,586
Bankat komerciale	-9,816	-12,749	-33,292
<b>Paraja gjithsej</b>	<b>625,489</b>	<b>848,918</b>	<b>860,940</b>
Paraja në qarkullim*	536,229	366,578	441,130
Depozita të sektorit privat	89,260	482,340	419,810
Llogaria rrjedhëse-ndërmarrjet	0	138,441	166,576
Llogaria rrjedhëse-individët	89,260	205,604	115,161
Llogaria e afatizuar dhe e kursimit-ndërmarrjet	0	31,158	25,568
Llogaria e afatizuar dhe e kursimit-individët	0	107,138	112,505

\*Paraja në qarkullim është vlerësuar në bazë të eksportit dhe importit të parasë së gatshme të realizuar nga ana e BPK-së dhe bankave komerciale.

Euro është valuta në përdorim më të gjerë në Kosovë (dinari serb ende përdoret në disa zona në Kosovë). Pas viteve të shumta të ballafaqimit me inflacion të lartë në ish Jugosllavi, implementimi i euros në Kosovë ka mundësuar një stabilitet rapid makroekonomik. Rritjet e theksuara fillestare të çmimeve, në shkallë vjetore dyshifrore, vazhduan me një stabilizim gradual të çmimeve në vitet 2001-2002. Krahasuar me vitin paraprak, çmimet e mallrave dhe shërbimeve konsumuese, në korrik të vitit 2002, ishin për 1.4% më të larta. Sidoqoftë, këto çmime, në dhjetor të vitit 2002, ishin diç më të ulta se sa në dhjetor të vitit 2001.

Marrë në tërësi, shkalla mesatare e çmimeve të konsumit, në vitin 2002, ishte për 3.6% më e lartë se ajo në vitin 2001, edhe pse në korrik, norma e krahasuar prej viti në vit ra në 1.4%, ndërsa, në dhjetor të vitit 2002, ishte diç negative. Gjithashtu, në vitin 2002, grumbullimi i tatimeve në Kosovë ishte më i lartë për 200 milion euro ose 15% e të gjitha mallrave dhe shërbimeve (për konsum dhe investime) të blera nga ekonomitë familjare të Kosovës. Sidoqoftë, gjatë kësaj kohe, shkalla mesatare e çmimeve në euro-zonë (Bashkimi Evropian) është rritur për 2.3%. Të dhënat, si duket, sygjerjnë një deflacion në të hyrat nga puna dhe profitet e bizneseve. Nëse ky process vazhdon, atëherë gjatë disa viteve të ardhshme, mund të presim rënie të mëtejme të theksueshme në të ardhurat nominale, në paga dhe çmime.

Siq shihet nga tabela e mëposhtme, shporta standarde e të mirave konsumuese, të blera nga një familje kosovare e përbërë nga 6.5 persona dhe e shprehur në euro, në vitin 2000 ishte 4,017, në 2001 ishte 4,484 dhe në 2002 ishte 4,643. Pjesëmarrja e mallrave ushqimor dhe e duhanit në këtë shportë ishte 44.2%. Gjithsej shuma e parasë së shpenzuar nga ana e familjeve kosovare, në blerjen e të mirave konsumuese, në vitin 2002, ishte 1,263 milionë euro. Në të njëjtën kohë, rreth 90 milionë euro ishte vlera e mallrave dhe shërbimeve të shitura ndërkombëtarëve me banim në Kosovë.

### Inflacioni i çmimeve: Kostoja e shportës mesatare të konsumit familjar

	2000	2001	2002	Gjithsej Mln euro
	Blerja e të mirave konsumuese, vjetore			
	për një familje			
	euro			
Gjithsej	4,017	4,484	4,643	1,263
Ushqim	1,743	1,964	2,053	558
Mallëra jo ushqimor	2,275	2,520	2,590	705

Cmimi mesatar në vitin paraprak=100

Gjithsej	100.0	111.6	103.6
Ushqim	100.0	112.7	104.5
Mallëra jo ushqimor	100.0	110.8	102.8

Burimi: MFE – NjM (Njësia Makroekonomike)

### Popullsia

Numri aktual i popullsisë së Kosovës (dhjetor 2002) është vlerësuar në 1.94 milion dhe ky është përafërsisht i njëjtë me atë në vitin 1990. Sidoqoftë, një numër i madh i njerëzve pat emigruar gjatë dekadës së fundit. Numri gjithsej i kosovarëve me banim jashtë, në fund të vitit 2002, ishte rreth 660,000, përfshirë këtu rreth 170,000 të cilët qenë të raportuar si anëtarë aktual të familjeve rezidente në Kosovë (pjesa dërmuese e tyre e përfshirë në Rexhistrin Civil të Kosovës) dhe 490.000 të cilët konsiderohen banorë të përhershëm ose shtetas të vendeve tjera. Rreth 85% e diasporës kosovare jeton në këto katër shtete: Gjermani, Zvicër, Austri dhe Serbi.

	Gjithsej	Rezidentët		Jorezidentët	
		Mijëra	%	Mijëra	%
Gjithsej	1,940	1,768	100.0	172	100.0
Rurale	1,200	1,080	61.9	120	69.8
Prej të cilave: Komuna e Prishtinës		49			
Urbane	740	688	38.1	52	30.2
Prej të cilave: Komuna e Prishtinës		175			

Numri mesatar i rezidentëve të Kosovës, në vitin 2002, është vlerësuar në 1.77 milion, ku rreth 90% janë shqiptarë, ndërsa 10% të tjerë kryesisht serb. Në Kosovë, gjatë verës ka më tepër njerëz, ndërsa gjatë dimrit më pak. Numri më i madh vie (bazuar në të dhënat nga vendkalimet kufitare) në qershor, ndërsa numri më i madh shkon në shtator. Këtij numri i janë shtuar edhe rreth 50.000 ndërkombëtarë të cilët punojnë në organizata të ndryshme të donatorëve, trupat e KFOR-it, vizitorët

afatshkurtër dhe turistët. Kështuqë, numri prej 1.82 milion personave është vlerësimi në të cilin mund të bëhet llogaritja e agregatëve kryesor makroekonomik, si të hyrat, pastaj konsumi dhe papunësia.

Rreth 62% e banorëve të Kosovës jetojnë në viset rurale. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë. Gjysma e popullsisë së saj është nën moshën 24 vjeçare; një e treta është nën moshën 15 vjeçare; 6% e saj është e moshës 65 vjeçare dhe më e vjetër. Gjithashtu, shkallët e fertilitetit - shkallët e përafërta të natalitetit dhe mortalitetit janë ndër më të ultat në Evropë. Madje, norma e lindjeve në vitin 2002 (21 veta në një mijë veta të popullsisë) është dukshëm më e ultë se ajo para njëzet viteve (rreth 32).

### Ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet

Tabela e mëposhtme pasqyron fuqinë punëtore “zyrtare” të punësuar në Kosovë në vitet 2000-2002. Numri mesatar i të punësuarëve në ndërmarrjet e përfshira në Rexhistrin e Bizneseve të EKS-së, në vitin 2002, ishte 190.000, ndërsa i atyre sipas ndërmarrjeve të rexhistruara si tatimpagues korent ishte 78.000. Këto të dhëna flasin për numër të vogël të të punësuarëve dhe derisa sipas Rexhistrin të Bizneseve, punësimi po rritet, sipas Administratës Tatimore ai po shënon rënie. Në fakt, kjo mund të jetë pasojë e kombinimit të sëpaku tre faktorëve: (1) zvogëlimi i punësimit, (2) rënia e disiplinës në pagesën e taksave dhe tatimeve, dhe (3) rënia e cilësisë së të dhënave (Rexhistrin i Bizneseve i EKS-së ka mungesë të azhuritit solid në procedura). Nuk ka informata të mjaftueshme për të ndriçuar këto tri mundësi.

### Punësimi i fuqisë punëtore (bazuar në të dhënat e Rexhistrin të Bizneseve dhe Administratës Tatimore)

	Rexhistri i Bizneseve	Administrata Tatimore	Raporti: Administratë Tatimore/Rexhistri i Bizneseve (%)
<b>Buxheti*</b>			
2000			
2001		61,741	
2002		65,406	
<b>Sektori jo-privat (ndërmarrjet publike dhe NPSH)**</b>			
2000	54,153	34,791	64.2
2001	61,023	36,490	59.8
2002	62,471	27,350	43.8
<b>Ndërmarrjet në sektorin privat**</b>			
2000	78,237	51,187	65.4
2001	112,180	61,808	55.1
2002	130,091	50,530	38.8

Burimi: MFE -NJM \* Fundi i vitit, \*\* Fundi i tremujorit të tretë

## Punësimi sipas sektorëve të ekonomisë, sipas burimeve të ndryshme

	Paguesit e tatimit në paga	Tatimi i ndërmarrjeve (Tatimi i paragjykuar dhe TVSH)	Rexhistri i Bizneseve i ESK-së	Hulumtimi i fuqisë punëtore i ESK-së në dhjetor të vitit 2001	HMSJ*
	1	2	3	4	5
Mijëra punëtorë					
<b>Gjithsej</b>	<b>132.4</b>	<b>77.9</b>	<b>192.4</b>	<b>400.4</b>	
Prodhimi	27.6	24.2	54.1	68.0	
Ndërtimtaria	5.0	5.4	22.5	34.0	
Tregtia	21.4	34.6	72.8	87.6	
Transporti dhe komunikacioni	4.7	4.4	15.7	20.0	
Financa	3.2	2.7	6.2	5.2	
Shërbimet personale dhe tjera	4.7	4.0	13.5	17.2	
Sektori i buxhetit					
Shëndetësia	13.0			28.8	
Arsimi	28.9			62.0	
Administrata publike dhe tjera	21.9			36.0	
Bujqësia	2.0	2.6	7.6	24.8	210
Sektori i donatorëve				16.8	

Shtylla 7: Numri i tatim paguesve, mesatarja për tremujorin e tretë 2002.

Shtylla 2: punëtorët tatim pagues.

\*HMSJ – Hulumtimi i Matjes së Standardit Jetësor

Nga të dhënat e më sipërme në dispozicion, shihet se numri më i madh i të punësuarëve është në bujqësi, prodhim, tregti dhe arsim.

Shembull brengosës është sektori i shëndetësisë ku punësimi është në rënie, ndërsa pagat janë ndër më të ultat në sferën e buxhetit dhe vazhdojnë duke rënë si në aspektin real ashtu edhe nominal.

## Konsumi

Evidenca anekdotale tregon se struktura e të ardhurave dhe konsumit nuk kanë ndryshuar shumë, përveq: (1) përmirësimi i impresiv të vendbanimeve dhe (2) rritjes së sasisë së automjeteve të udhëtimit dhe të mirave të konsumit – shumica prej tyre e sjellur në Kosovë si pronë e të riatdhesuarëve të kthyer ose e ofruar nga anëtarët e familjeve të tyre si dërgesë mallrash.

Ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet	Ditore	Vjetore (2002)		
	per capita	Gjithsej		
		Në para të gatshme dhe jo të gatshme		
	Euro	Mln euro	%	Mln euro
<b>Të ardhurat: gjithsej, në para të gatshme*</b>	<b>3.06</b>	<b>1,973</b>	<b>100.0</b>	
Të ardhurat nga puna	1.29	833	42.2	
Pagat dhe të ardhurat nga buxheti	0.22	144	7.3	144
Pagat nga punësimi i ndërlidhur me donatorët	0.29	186	9.4	186
Pagat në bujqësi	0.02	15	0.8	15
Të ardhurat tjera nga puna	0.76	488	24.7	488
Transferrat social, përfshirë pensionet	0.11	70	3.5	
Buxheti i Kosovës	0.08	53	2.7	53
Buxheti i Serbisë	0.03	17	0.9	17
Të ardhurat tjera (prej bizneseve)	0.50	320	16.2	320
Dërgesat e të çatdhësuarëve**	1.16	751	38.1	751
<b>Konsumi: gjithsej</b>	<b>2.58</b>	<b>1,665</b>	<b>84.4</b>	
Blerjet gjithsej (në para të gatshme)	1.96	1,263	64.0	
Mallra ushqimor dhe duhan	0.87	558	28.3	558
Mallra jo ushqimor	1.09	705	35.7	705
Gjërat e prodhuara vetanake	0.25	163	8.3	
Mallra ushqimor	0.23	148	7.5	
Mallra jo ushqimor	0.02	15	0.8	
Banimi (përlogaritur)	0.17	110	5.6	
Dhuratat (përfshirë dërgesat në mallra	0.20	129	6.5	
<b>Investime Rezidenciale në Banim: gjithsej**</b>				
<b>Shpenz. e përlogaritura (përfshirë f.punëtore vehtiake)</b>	<b>0.17</b>	<b>110</b>	<b>5.6</b>	
Pagesat ndaj kontraktuesve	0.03	19	0.9	19
Materialet e blera	0.10	63	3.2	63
Materialet vehtiake	0.12	77	3.9	
Fuqia punëtore vehtiake	0.03	21	1.1	
<b>Investime Komerciale: gjithsej**</b>	<b>0.30</b>	<b>196</b>	<b>9.9</b>	
Gjendja e kapitalit fiks	0.26	170	8.6	170
Ndryshimi në stoqe	0.04	26	1.3	26
<b>Taksat dhe tatimet e paguara (Të hyrat e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës)</b>	<b>0.77</b>	<b>494</b>	<b>25.1</b>	494
<b>Kontributet në Fondin e Pensioneve</b>	<b>0.00</b>	<b>1</b>	<b>0.1</b>	1
<b>Kursimet (ndryshimi në llogarinë bankare të kursimeve)</b>	<b>-0.10</b>	<b>-62</b>	<b>-3.1</b>	-62

\* Subsidimet nga donatorët nuk janë përfshirë

\*\* Subsidiimet nga Buxheti Gjeneral i Kosovës dhe donatorët nuk janë përfshirë

## Ndërmjetësimi financiar

Tre vitet e kaluara dëshmojnë për një zhvillim rapid të ndërmjetësimit financiar në Kosovë e posaçërisht të sistemit bankar. Këtë ekspansion rapid të aktiviteteve bankare e ilustron rritja rreth pesëfish e numrit të njësive të bankave (bankat komerciale dhe filialat e tyre) – si në periudhën dhjetor 2000/dhjetor 2001, ashtu edhe në atë dhjetor 2001/dhjetor 2002 (shih tabelën e mëposhtme). Shuma vjetore e operacioneve ndërbankare, në periudhën 2001-2002, është rritur

rreth dhjetëfish. Raporti mes operacioneve bankare dhe aktiveve, gjatë kë saj kohe, është rritur për gjashtë herë dhe atë nga 0.33 në 1.91.

### Ndërmjetësimi financiar

	2000	2001	2002
Bankat komerciale, fundi i vitit, numri i filialave dhe ekspoziturave	5	24	112
IVF-të dhe inst. financ. jobankare, fundi i vitit, numri i njësisve operuese	10	29	40
Aktivitet e bankave komerciale, fundi i vitit, milionë euro	103	518	471
Prej të cilave: kamatë prurëse, %	66.4	39.7	76.8
Pasivitet e bankave komerciale, fundi i vitit, milionë euro	103	519	471
Prej të cilave: Depozitat	93	492	427
Prej të cilave: Entitetet legale		169	192
Personat fizik		313	228
Depozitat pa afat		344	282
Depozitat e afatizuar		138	138
Kredi komerciale, fundi i vitit, milionë euro	6	47	120
Operacionet ndërbankare, numri i transaksioneve		5,124	75,763
Operacionet ndërbankare, shuma gjithsej, milionë euro		86	841
Mesatarja vjetore e shumës së aktiveve, milionë euro		260	439
Koeficienti i qarkullimit: operacionet ndaj aktiveve		0.33	1.91
Transferrat elektronik (komercial): qarkullimi gjithsej, milionë euro	468	1,141	1,591
Hyrëse – bruto	293	630	854
Dalëse – bruto	175	511	737
Hyrëse – neto	117	119	118
Eksportet e mallrave komerciale gjithsej - bruto, milionë euro*	19	23	27
Importet e mallrave komerciale gjithsej - bruto, milionë euro	372	660	934
Importet e mallrave komerciale gjithsej – neto, milionë euro	353	637	906
Koeficienti: transferrat dalëse bruto ndaj importeve bruto, %	47.1	77.4	78.9

Këto të dhëna tregojnë gjithashtu se bankat realizuan pagesa konform përqindjes së rritur të importeve. Përmes bankave, një numër i madh i individëve dhe i bizneseve kreu veprime të ndryshme financiare, blerje dhe shitje, transferta në të gatshme, etj.

Megjithatë, si sistemi bankar ashtu edhe ndërmarrjet jo financiare nuk janë ende të gatshme për iniciimin/mbështetjen e projekteve të mëdha investive në sektorin privat. Me përjashtim të (ri)ndërtimit të shtëpive, gjatë tre viteve të kaluara, investimet private në Kosovë ishin të vogëla. Rreth 80% e kreditit bankar është kredit afatshkurtër dhe si i tillë ai nuk mbështetë investimet afatgjata. Shumica e depozitave janë depozita të pa afatizuar.

Rritja rapide e depozitave bankar gjatë vitit 2000 dhe 2001, midis tjerash, reflekton rritjen e kursimeve të popullsisë. Një ndryshim i theksuar ngjau në vitin 2002. Përderisa balanca e llogarive qeveritare në BPK (suficiti buxhetor në të gatshme) u rrit për 120 milionë euro, shuma e balancës së llogarisë së kursimeve të popullsisë në banka komerciale shënoi rënie për 85 milionë euro. Kjo u zvogëluar nga 313 milionë euro, sa ishte në fund të 2001, në 242 milionë euro (mars 2002), për t'u qetësuar më vonë në rreth 225 milionë euro. Me sa shihet, një rënie e paraparë në aktivitetet e donatorëve dhe dërgesat e të çatdhesuarëve do të pengojë rritjen e këtyre kursimeve në vitin 2003 dhe më tutje.

## Tregtia e Jashtme dhe Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave të Kosovës mund të cilësohet si tepër i ekspozuar rrezikut. Si në vitet e mëparshme, ashtu edhe në vitin 2002, ekonomia e Kosovës vazhdon të mbetet tepër e varur nga asistenca e huaj, dërgesat e të çatdhesuarëve dhe importet. Zhvillimet në bilancin e pagesave varen drejtpërdrejtë nga zhvillimet e këtyre tre faktorëve.

Ngjashëm si në të kaluarën, dërgesat e të çatdhesuarëve (diasporës kosovare) ishin relativisht stabile duke kontribuar në mbijetesën e rreth 80% të familjeve kosovare. Koefficienti i dërgesave të të çatdhesuarëve ndaj PBB-së, në vitin 2002, ishte në shkallë pothuajse të pandryshuar (30% e PBB-së). Këto dërgesa ishin kryesisht të destinuara në konsumin personal dhe riparimin e shtëpive private.

### Kosovë: Bilanci i Pagesave\*, euro milionë, nëse nuk është cekur ndryshe

	2000	2001	2002
<b>Bilanci Tregtar</b>	<b>-968</b>	<b>-827</b>	<b>-999</b>
Eksportet	148	231	246
Importet	-1,116	-1,058	-1,246
<b>Shërbimet e tipit jo faktor</b>	<b>-935</b>	<b>-992</b>	<b>-730</b>
Marrjet	0	0	1
Pagesat	-935	-992	-731
<b>Të ardhurat e tipit faktor</b>	<b>649</b>	<b>688</b>	<b>658</b>
Dërgesat e punëtorëve të çatdhesuar	472	524	526
Të ardhura faktori nga punësimi me donatorët	177	163	132
<b>Transfertat</b>			
<b>Asistenca e ofruar nga donatorët</b>	<b>1,336</b>	<b>1,290</b>	<b>1,032</b>
PIP plus fondet me destinim	628	551	411
Asistenca humanitare	36	18	9
Fondet buxhetore të padestinuara	102	60	10
Shërbimet e përlogaritura të ofruara nga donatorët	570	661	602
<b>Bilanci i llogarisë korente</b>	<b>83</b>	<b>159</b>	<b>-40</b>
<b>Në përqindje të PBB-së</b>	<b>5.8</b>	<b>9.1</b>	<b>-2.0</b>
<b>Bilanci i llogarisë kapitale</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>10</b>
IJD (Investimet e jashtme direkte)	0	5	10
Investime portofoli	0	0	0
Huatë	0	0	0
<b>Gabime dhe harresa</b>	<b>-83</b>	<b>192</b>	<b>103</b>
Bilanci i përgjithshëm	0	356	73
<b>Ndryshim i Rezervave Ndërkombëtare Neto (- irritje)</b>	<b>0</b>	<b>-356</b>	<b>-73</b>
Rezervat Ofiçiale	n/a	-234	-39
Rezervat ndërkombëtare të sistemit bankar neto	n/a	-122	-35

\*Vlersimet e stafit të FMN-së (2000/2001) dhe parashikimet (2002) – përgatitur nga Misioni i FMN-së i shtatorit 2002


Përkundër shenjave të zvogëlimit, asistenca e huaj mbeti forca kryesore udhëheqëse e rritjes ekonomike të Kosovës në vitin 2002. Projektionet e vitit të kaluar si dhe vlersimet e sivjetshme preliminare të bëra nga ana e stafit të FMN-së tregojnë se asistenca e huaj përbën gati gjysmën e PBB-së së Kosovës. Duke vijuar reduktimin modest të asistencës së përgjithshme të huaj, llogaria korente, në vitin 2002, tregoi deficit të moderuar në vlerë prej 2% të PBB-së.

Performansa e bilancit tregtar të Kosovës është më tepër se alarmante. Të dhënat për vitin 2002 tregojnë se ekonomia kosovare me eksportet e saja mund të mbulojë vetëm një të pestën e importeve të saja dhe se deficitin në bilancin tregtar përbën më tepër se gjysmën e PBB-së. Aq më tepër, të dhënat e fundit tregojnë se, në vitin 2002, eksportet e rregullta (përjashtuar këtu eksportet e ndërlidhura me konsumin e KFOR-it dhe konsumin e jorezidentëve) kapin shumën prej 27.32 milionë euro dhe faktikisht mund të mbulojnë vetëm 2.0-2.5% të importeve të Kosovës. Ky është më tepër se një përjashtim, madje edhe për vendet në regjion. Sa për krahasim, në vitin 2001, Serbia dhe Mali i Zi shënuan deficit tregtar afër 30% të PBB-së, pastaj Shqipëria mbi 20% dhe Maqedonia nën 15%.

Kthimi i eksporteve në bilancin tregtar të Kosovës flet se këtu ka ca shenja pozitive të përmirësimit të strukturës themelore në ekonomi. Me përjashtim të mallrave të grupuara si eksporte tjera, pjesëmarrjen më të lartë në eksporte e patën pajimet elektrike bashkë me produktet dhe pjesët prej metali (35%). Lëkura, birra, verërat dhe kërpudhat – të gjitha sëbashku vijjnë të dytat me pjesëmarrje prej 21%.

### Tregtia e jashtme: Eksportet sipas mallrave të zgjedhura, euro milionë


Burimi: Shërbimi Doganor i Kosovës dhe MFE -NjM



Përmirësimi i mëtejshëm dhe më sinjifikant i performancës së eksporteve do të jetë çështje kryesore në vitet që vijnë. Marrë parasysh strukturën ekzistuese të importeve të mallrave është e arsyeshme të pritet një zëvendësim gradual i një shkalle të konsiderueshme të mallrave nga importi me mallrat e prodhuara brenda vendit. Përderisa participimi i lartë i importeve të karburanteve (13%) dhe deri në njëfarë mase edhe i prodhimeve kimike dhe prej drurit (13.7%) është i kuptueshëm, më tepër se dëshpërues është fakti se importet e mallrave ushqimor dhe duhanit zëjnë pozitë dominante (30%) në bilancin tregtar të një ekonomie përndryshe agrare.

Shikuar në tërësi, me sjelljen në jetë të reformave strukturale të anticipuara (privatizimi, reduktimi i ekonomisë nën hije, adoptimi i legjislativitetit modern) do të krijohen motive më fortë të arsyeshme për lëvizjen e ekonomisë në drejtim të shfrytëzimit më efikas të resurseve vendore.


## Tregtia e jashtme: Importet sipas grupmallrave, euro milionë



Burimi: Shërbimi Doganor i Kosovës dhe MFE - NjM

Partnerët tregtarë kryesor të Kosovës janë Bashkimi Evropian dhe Maqedonia. Në dy vitet e fundit është rritur dukshëm tregtia me Serbinë, Turqinë, Shqipërinë dhe Bullgarinë. Edhe Sllovenia me Kroacinë, posaçërisht pas hapjes së zyrave përfaqësuese të odave të tyre ekonomike, janë duke shtuar prezencën e tyre në tregun e Kosovës.

## Tregtia e jashtme: Importet sipas vendngarkimit, euro milionë



Burimi: Shërbimi Doganor i Kosovës dhe MFE - NjM

Të dhënat mbi strukturën gjeografike të eksporteve (sipas destinimit të shteteve) nuk janë ende të disponueshme. Të dhënat mbi eksportet sipas pikave kufitare tregojnë se më tepër se gjysma e eksporteve shkuan nëpër kufirin me Maqedoninë (pika vendkaluese kufitare Hani i Elezit).

Struktura gjeografike e importeve duket të jetë e mjegulluar për shkak të mungesës së të dhënave detale mbi importet sipas origjinës së mallrave. Maqedonia, me qëllim të përfitimit sa më të madh nga Marrëveshja mbi tregtinë e lirë midis RFJ-së dhe Maqedonisë (shkalla doganore vetëm 1%) e cila

që nënshkruar qysh para periudhës së luftës, vazhdon të lëshojë certifikata maqedonase mbi origjinën e mallit edhe për mallrat që kanë origjinë nga shtetet tjera.

## Politika Fiskale

### Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

	2000	2001	2002
	<i>Milionë euro</i>		
<b>Të hyrat</b>	<b>128.5</b>	<b>323.0</b>	<b>497.9</b>
Qeveria Qendrore	128.5	308.0	478.0
Prej të cilave: TVSh në importe	63.4	127.2	169.0
Dogana	32.3	47.6	67.5
Akciza kufitare	19.5	77.0	125.6
Taksat komunale të veta	0.0	15.0	19.9
<b>Shpenzimet</b>	<b>234.9</b>	<b>281.3</b>	<b>429.2</b>
Shpenzimet korentë	234.9	274.6	413.3
Pagat	92.3	109.5	130.9
Mallrat dhe shërbimet	74.4	96.8	148.8
Prej të cilave: MDD të financuara	31.1	35.5	26.9
Transfertat dhe subsidimet	67.4	74.2	133.6
Prej të cilave: Ndërmarrjeve shtetërore <sup>1</sup>	32.2	39.6	76.3
Prej të cilave: për investime	17.0	14.0	46.0
Tjera	0.8	-5.9	0.0
Shpenzimet kapitale	0.0	6.6	15.9
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>-106.4</b>	<b>41.7</b>	<b>68.7</b>
Financimi	106.4	-41.7	-68.7
Grante buxhetit	160.6	83.7	39.0
Grantet e Destinuara nga Donatorët	40.0	42.6	20.9
Mbështetje buxhetit	120.6	41.1	18.1
Tjerar (+ tërheqjet)	-54.2	-125.5	-107.7
Ndryshimi në bilancet e fondeve të destinuara	-8.9	-7.2	6.0
Ndryshimi në bilancet tjera bankare	-45.3	-118.3	-113.7
	<i>% e PBB-së</i>		
<b>Të hyrat</b>	<b>9.1</b>	<b>18.5</b>	<b>25.0</b>
<b>Shpenzimet</b>	<b>16.6</b>	<b>16.1</b>	<b>21.6</b>
Shpenzimet korentë	16.6	15.7	20.8
Shpenzimet kapitale	-	0.4	0.8
<b>Bilanci i përgjithshëm (para granteve buxhetit nga donatorët)</b>	<b>-7.5</b>	<b>2.4</b>	<b>3.5</b>
Grante buxhetit	11.4	4.8	2.0
<b>Bilanci i përgjithshëm (pas granteve buxhetit nga donatorët)</b>	<b>3.8</b>	<b>7.2</b>	<b>5.4</b>

Burimi: Misioni i FMN-së (mars 2003)

Vërejtje: <sup>1</sup>Viti 2002 përfshinë shpenzimin e njëhershëm për KEK-un për dëmet e pësuar nga rrufeja gjatë mesit të verës.

Fal politikës fiskale të kujdesshme, edhe në vitin 2002, pozita fiskale e Kosovës mbetet e qendrueshme me një bilanc të përgjithshëm suficitar për herë të dytë me radhë. Shkalla e përgjithshme e suficitit të buxhetit të konsoliduar (kur përjashtojmë grantet dhënë buxhetit) u rrit nga 41.7 milionë euro (2.4% e PBB-së), sa ishte në vitin 2001, në 68.7 milionë euro (3.5% e PBB-së) në vitin 2002.

Taksat dhe tatimet e reja vendore, të implementuara në prillin e fundit, i sollën buxhetit të hyra plotësuese në vlerë prej 6.4 milionë euro, por, edhe përkundër zgjerimit të TVSh-së (korrik 2001) që të mbulojë sa më shumë ndërmarrje, pjesëmarrja e TVSh-së së brendshme në të hyrat gjithsej nga TVSh-ja mbeti në një shkallë të ultë.

### Sektori publik: Qeveria

Shpenzimet gjithsej	2000	2001	2002	2003
Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës*	235	283	376	510
UNMIK-u**	413	449	388	368
PIP/OJQ-të***	635	541	292	270
KFOR-i****	5,000	4,000	3,000	2,000
<b>Sektori publik gjithsej</b>	<b>6,282</b>	<b>5,273</b>	<b>4,057</b>	<b>3,148</b>
Ekonomitë familjare, fermat dhe ndërmarrjet*****			2,442	

Burimi: MFE - NJM

\*Nuk janë përfshirë transfertat e asistencës sociale,

\*\*Pagat e paguara të huajve përfshirë vetëm kur janë paguar nga buxheti i UNMIK-ut,

\*\*\*Nuk janë përfshirë subsidimet ndaj Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës,

\*\*\*\*Vlersime të përafërta (mungojnë të dhëna të sakta),

\*\*\*\*\*Konsumi i mallrave në natyrë është përfshirë

Të hyrat gjithsej të buxhetit të konsoliduar (përjashtuar grantet buxhetit) janë rritur dukshëm në vitin 2002. Të hyrat nga tatimet e grumbulluara në kufi, në vitin 2002, përbënin komponentën kryesore të të hyrave të përgjithshme (rreth 75%). Edhe pse shkalla e të hyrave është rritur gjatë kësaj periudhe nga 14.3% e PBB-së (viti 2001) në 21.8% të PBB-së (viti 2002), të hyrat nga jotatimet janë rritur në mënyrë të moderuar nga 2.3% e PBB-së (viti 2001) në 3.7% të PBB-së (viti 2002).

Gjithashtu, edhe shkalla e shpenzimeve të buxhetit të konsoliduar shënoi rritje të theksuar gjatë vitit 2002. Shpenzimi korent përbënte komponentën kryesore të shpenzimeve të tërësishme në vitin 2002 (96.3%). Sidoqoftë, shpenzimet e buxhetit u rritën gati në shkallë të njëjtë me atë të të hyrave.

## **Struktura dhe Funkcionet**

### **Struktura Organizative**

BPK-ja është e organizuar në tre divisione kryesore – Mbikëqyrja Financiare, Veprimet Bankare dhe Veprimet Financiare. Secila nga këto divisione ka qartë të definuar rolet të cilat më së miri i shërbejnë institucioneve financiare të Kosovës, Institucioneve të Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës (IVPK-së) dhe UNMIK-ut, ndërsa në të njëjtë kohë mbrojnë edhe interesin e publikut të gjerë.

#### **RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E SEKTORIT FINANCIAR**

Rregullorja nr.2001/24 e amenduar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, e vendosi në BPK përgjegjësinë për liçencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Kosovë. Ndarja e përgjesisë legale për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar i është dhënë tre departamentëve:

- Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare,
- Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, dhe
- Departamenti i Mbikëqyrjes së Pensioneve.

### **Mbikëqyrja Bankare**

Korniza e mbikëqyrjes bankare e BPK-së është e organizuar në pesë komponente kryesore. Këto janë të lidhura mes vet për të ofruar një sistem efikas të mbikëqyrjes bankare dhe asnjëra komponentë nuk vepron e pavarur prej tjetrës:

- Filozofia mbikëqyrëse,
- Normat dhe rregulloret prudenciale (maturisë),
- Politika dhe procedurat, teknikat dhe mjetet e mbikëqyrjes,
- Monitorimi mbikëqyrës, dhe
- Reagimet mbikëqyrëse.

### **Filozofia Mbikëqyrëse**

Qëllimi i BPK-së është të ketë mbikëqyrje bankare dhe proces rregullativ efektiv, fleksibil dhe që promovon sistem bankar të mbështetur në konkurrencën e tregut si dhe që plotëson Parimet Themelore të Bazelit për Mbikëqyrje Efektive Bankare. Këshilltarët ndërkombëtarë të mbikëqyrjes bankare nga USAID-i kanë vazhduar që, edhe gjatë vitit 2002, të ndihmojnë në krijimin e funksionit të mbikëqyrjes bankare i cili bazohet në përvojat më të mira ndërkombëtare. Qasja mbikëqyrëse e adoptuar nga BPK-ja mbështetet në sistemin e bazuar të rrezikut. Qasja e këtillë ka për qëllim t'i mundësoj BPK-se shpërndarjen e drejtë të burimeve të saja mbikëqyrëse në fushat e rrezikut të lartë brenda bankave individuale dhe sistemit bankar. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik përqendrohet në aftësinë e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun.

Një prej objektivave kryesore të këshilltarëve ndërkombëtar është realizimi i transferimit të plotë të përgjegjësisë të mbikëqyrjes bankare ke stafi vendor kosovar i mbikëqyrjes bankare. Një menaxher vendor, gjatë tremujorit të parë të vitit 2003, do të zgjedhet udhëheqës kryesor i Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.

## **Normat dhe Rregulloret Prudenciale**

Objektiv i BPK-së, në fushën e rregullimit bankar, është që të ketë një kornizë ligjore bankare e cila është në vijë me udhëzimet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Rregullorja nr.1999/21 ofron kornizën për liçencimin e bankave dhe të institucioneve financiare jobankare, pastaj për organizimin dhe qeverisjen e bankës, nxjerrjen e normave dhe urdhërësive prudenciale, mbajtjen e evidencave dhe llogarive financiare në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), nevojat për auditim të jashtëm dhe inspektime të brendshme (on-site) dhe zbatimin e masave të detyrimit dhe dënimeve që kanë për qëllim sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloren.

Deri në përfundim të vitit 2002 janë aprovuar, nga ana e Bordit Drejtues, 22 rregulla mbikëqyrëse prudenciale, të cilat si të tilla përcaktojnë kufizimet, udhërrëfimin e veprimeve, të procedurave dhe nevojave të raportimit për bankat dhe institucionet financiare. Zhvillimet më të rëndësishme rregullative në vitin 2002 përfshijnë:

- Effektivisht, nga 1 janari i vitit 2002, është rritur në 2.5 milionë euro minimumi i kapitalit të domosdoshëm për liçencë banke. Bankave tashmë të liçencuara u ishte dhënë afat që deri më 31 dhjetor të vitit 2002 të përmbushin limitin e ri të kërkuar për kapital.
- Bordi Drejtues, më 28 mars 2002, ka adoptuar Rregullën XXII mbi Ndryshimet në Llogaritë e Kapitalit Aksionar të Bankës. Rregulla specifikon kërkesat për të qenë të aprovuara nga ana e BPK-së mbi ndryshimet në kapitalin aksionar të bankave.
- Bordi Drejtues, më 15 dhjetor 2002, ka amandamentuar Rregullën I mbi Kapitalin e bazuar në rrezikun. Kjo Rregullë u amandamentua me qëllim aplikimi të 75% të mjeteve të rrezikuara nga kreditë e siguruara me të drejtë parësore në hipoteka të banimit.

## **Politikat dhe Procedurat Mbikëqyrëse**

Janë zhvilluar dhe implementuar dy doracakë mbi politikën e mbikëqyrjes së bankës – doracaku i liçencimit të bankës dhe doracaku i mbikëqyrjes së bankës, të cilët përmbledhin politikat dhe procedurat e liçencimit dhe të mbikëqyrjes. Me qëllim të sigurimit të një kornize efektive për funksionim të shëndoshë të sistemit bankar, gjatë vitit 2002, është vazhduar me freskimin dhe zhvillimin e procedurave uniforme mbi liçencimin dhe ekzaminimet brenda (on-site) dhe jashtë (off-site) bankave.

Doracaku mbi liçencimin e bankave përmban format dhe procedurat e standardizuara të liçencimit të bankave dhe të institucioneve financiare jobankare. Doracaku mbi mbikëqyrjen e bankave ofron procedurat standarde të mbikëqyrjes së brendshme (on-site) të bazuara në sistemin pesëshkallësh të CAMEL-it<sup>4</sup>, i cili përcakton rejtingun bankar dhe lejon një efikasitet dhe konzistencë të lartë në kryerjen e inspektimeve dhe ekzaminimeve.

Gjatë vitit 2002 janë bërë edhe modifikime tjera në njësinë e BPK-së për mbikëqyrjen e bankave. Janë zhvilluar katër doracakë të rinj të mbikëqyrjes, përfshirë: (1) Teknologjinë Informativë (TI) Doracakun e Ekzaminimit; (2) Librin udhëzues mbi Procesin e Mbikëqyrjes së Bankave; (3) Politikën e Mbikëqyrjes së Bankës dhe Detyrimet; dhe (4) Doracakun mbi Administrimin e Përkohshëm të Bankës nën Administrim të Përkohshëm/Likuidim. Me qëllim të sigurimit të konzistencës në aktivitetet e mbikëqyrjes, politikat dhe procedurat e reja do të formalizojnë edhe më tutje funksionet e njësisë së mbikëqyrjes bankare.

### **Aktivitetet Mbikëqyrëse Monitoruese**

Aktivitetet mbikëqyrëse monitoruese përfshijnë aktivitetet e liçencimit të bankave, inspektimet periodike të brendshme (on-site) dhe vëzhgimin e vazhdueshëm nga jashtë (off-site). Për realizimin e

---

<sup>4</sup> Përshtatshmëria e Kapitalit, Cilësia e Aktiveve, Menaxhmenti, Të Ardhurat dhe Likuiditeti

kësaj përgjegjësie që del nga Rregullorja nr.1999/21 mbi liçencimin dhe mbikëqyrjen e banakve dhe institucioneve financiare, Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankave është duke ndjekur një qasje mbikëqyrëse të mbikëqyrjes së vazhdueshme përmes inspektimeve të brendshme (on-site) dhe monitorimit nga jashtë (off-site).

## **Liçencimi**

Strategjia e BPK-së, në fushën e liçensimit të bankave, është e përqendruar në tërheqjen e investitorëve të cilët, duke pasur pozitë të fortë financiare, aksionarë dhe menaxhment të përshtatshëm, janë në gjendje të ushtrojnë qasje të matur në veprimet bankare që për qëllim kanë mbrojtjen e interesit të klientëve të tyre si dhe ndihmën në forcimin e sistemit bankar dhe rritjen e besueshmërisë së tij.

Aktiviteti liçencues i BPK-së, gjatë vitit 2002, ishte i ndërlidhur me themelimin e bankave, hapjen e filialave të bankave dhe ndryshimet në strukturën pronësore të bankave. Asnjë bankë e re nuk është liçencuar nga BPK-ja gjatë vitit 2002, kështuqë numri i bankave të liçencuara mbeti në shtatë banka. Gjatë vitit 2002, nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare, janë procesuar dy aplikacione për liçencë banke. Njërit aplikacion i është dhënë pëlqimi paraprak, nga ana e Bordit të Guvernatorëve, ndërsa aplikacioni tjetër që refuzuar me justifikim se nuk i plotësoi kërkesat për liçencë banke të specifikuar sipas Rregullores nr.1999/21.

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, gjatë vitit 2002, procesoi 93 aplikacione për filiala të bankave locale, të cilat e zgjeruan rrjetin e tyre operues në tërë Kosovën. Krahasuar me vitin 2001 (25), numri i filialave operuese të bankave, në fund të vitit 2002, ishte dukshëm më i lartë (118) duke mundësuar kështu një qasje më të gjerë shërbimeve bankare nga ana e qytetarëve dhe ndërmarrjeve.

Nisur nga kërkesa për rritjen e kapitalit në minimumin prej 2.5 milionë, përfundimisht më 31 dhjetor të vitit 2002, është bërë procesimi i një numri të madh të kërkesave nga bankat locale të cilat kanë të bëjë me ndryshimet në strukturë të pronësisë. Në përfundim të vitit 2002, të gjitha bankat e kanë përbushur me sukses kërkesën e re për kapital.

Gjatë vitit 2002, ngjarje sinjifikante në zhvillimin e sistemit bankar ishte blerja e 76% të aksioneve të Bankës Amerikane të Kosovës (ABK) nga ana e filialës së Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG (RZB-Austria) me seli në Vienë – institucioni kryesor i Raiffeisen Banking Group, i cili përfaqëson grupin e dytë bankar për kah madhësia në Austri. Përmes blerjes së shumicës së aksioneve të ABK-së, RZB-ja bëri zgjerimin e rrjetit të vet bankar në Ballkan dhe planifikon implementimin e produkteve kreditore dhe shërbimeve të reja bankare për klientët dhe bizneset e locuara në Kosovë. USAID-i vazhdon të jetë aksionar në RZB përmes Fondit të Financimit të Bizneseve në Kosovë.

## **Ekzaminimet e brendshme (On-Site)**

Aktiviteti inspektues dhe ekzaminues, i ndërmarrë gjatë vitit 2002, është realizuar në bazë të Planit vjetor të inspektimit të aprovuar nga ana e Zëvendës Drejtorit Gjeneral për Mbikëqyrje Financiare. Gjatë vitit të kaluar, inspektorët e BPK-së realizuan 21 inspektim të brendshëm në banka duke përfshirë këtu gjashtë ekzaminime të plota, nëntë inspektime qëllimore dhe gjashtë inspektime të Teknologjisë Informative. Gjithashtu, gjatë këtij viti, u realizuan edhe dhjetë inspektime të brendshme (on-site) në institucionet kreditore jobankare.

## **Analizat e jashtme (Off-Site)**

Është zhvilluar një proces i mbikëqyrjes së jashtme (off-site). Analizat dhe mbikëqyrja e jashtme e bankave, gjatë vitit 2002, përfshiu me sa vijon: (1) analiza mujore të vazhdueshme të bankave

komerciale të bazuara në raportet rregullative të standardizuara të bankave; dhe (2) një analizë e përgjithshme e sistemit bankar me qëllim zbulimi të çështjeve të rrezikut të përgjithshëm.

### Reagimet mbikëqyrëse/masat e detyrimit

Rregullorja nr.1999/21 përmban dispozitat mbi masat e detyrimit lidhur me mospërshtatjen me rregulloren dhe rregullat e BPK-së, ose për praktikat bankare të pasigurta dhe jo të shëndosha. Sipas rregullorës, masat e detyrimit sillen prej vërejtjes me shkrim e deri të revokimi i liçencës. BPK-ja, gjatë 2002, ka dënuar me gjobë një bankë e cila ka bërë shkelje rregullative, ndërsa një bankë tjetër, për shkak të problemit të menaxhimit të kredive, që futur nën Marrëveshjen Formale me BPK-në.

### Personeli dhe Trajnimi

Zhvillimi i personelit profesional mirë të trajnuar të mbikëqyrjes bankare dhe i cili është i afërt me teknikat moderne të mbikëqyrjes bankare të bazuar në rrezikun - vazhdon të mbetet si qëllim i BPK-së. Është zhvilluar një program formal i trajnimit të mbikëqyrësve bankar. Programi trajnues përfshinë si trajnimin formal përmes sesioneve ashtu edhe trajnimin përmes punës. Ofruar nga ana e një eksperti ndërkombëtar për trajnime të mbikëqyrjes bankare, gjatë vitit 2002, janë mbajtur shtatë seminare formale trajnimi përmes sesioneve në lëmitë vijuese: Mbikëqyrja Themelore Bankare, Analizat e Jashtme të Avansuara, Etika dhe Sjellja Profesionale e Mbikëqyrësve, Pastrimi i Parave, Trajnimi i Trajnerëve dhe Teknikat e Menaxhimit të Ekzaminimit.

Seminareve formale të mbikëqyrjes bankare, në vitin 2002, duhet shtuar edhe trajnimin, përmes procesit të punës së drejtpërdrejtë të mbikëqyrësve bankarë - gjatë inspektimeve të tyre të brendshme dhe aktiviteteve monitoruese të jashtme, ofruar nga këshillëtarët ndërkombëtarë.

### Struktura e Sektorit Financiar

Lloji i Institucionit Financiar	Numri	Numri i Zyrave
Bankat e liçencuara	7	118
Bankat me liçencë preliminare të aprovuar	1	S'ka
Institucionet e Vogëla Financiare	16	29
Byrotë e Këmbimit	3	3
Operatorë me Transferta Elektronik	2	56

### Zhvillimi i Sistemit Bankar

Viti 2002 vazhdoi të jetë vit i zhvillimit për bankat në Kosovën e pasluftës. Edhe pse numri i bankave nuk ndryshoi, gjatë vitit 2002, shumica e bankave ishin mjaft agresive në zgjerimin e rrjetit të zyrave bankare (filialave dhe ekspoziturave) nëpër Kosovë. Më 31 dhjetor të vitit 2002, aktivet gjithsej të sistemit bankar ishin 471 milionë euro; kreditë gjithsej 86 milionë euro dhe depozitat gjithsej 420 milionë euro. Krediti gjithsej i lejuar nga sistemin bankar, gjatë vitit 2002, u rrit për 61 milionë euro ose 244%. Në të njëjtë kohë, depozitat gjithsej në sistemit bankar, në fund të vitit 2002, u zvogëluan për 65 milionë euro ose për 13%. Rënia e depozitave, gjatë vitit 2002, pjesërisht i referohet tërheqjes së depozitave në gjysëmvetorin e parë të vitit, e cila erdhi pas rritjes së theksuar të depozitave bankare në prag të fillimit të kalimit në valutën euro (janar 2002). Gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2002, depozitat e sistemit bankar u zvogëluan për 23%, por prej korrikut deri në dhjetor të vitit 2002 shënuan rritje për 13%.

## Kreditë dhe Depozitat e Sektorit Financiar – 31 dhjetor, 2002 (mijëra euro)

	Kreditë	Depozitat
Bankat	86,612	419,436
IVF-të dhe jobankare	33,437	0
Gjithsejl	120,049	419,436

E matur sipas kapitalit aksionarë, struktura pronësore e sistemit bankar, më 31 dhjetor 2002, ishte me sa vijon: 62% kapital i jashtëm dhe 38% kapital vendor. Në Kosovë nuk kemi banka në pronësi shtetërore, por diku rreth 5% të kapitalit aksionarë të sistemit bankar i takon ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

Zhvillimet tjera të theksueshme në sistemin bankar, gjatë vitit 2002, kanë të bëjë me instalimin e sporteleve automatike (ATM) nga ana e MEB-it (Micro Enterprise Bank). Në fund të vitit, MEB-i kishte 14 sportele automatike. Poashtu, gjatë vitit 2002, dy banka (Micro Enterprise Bank dhe American Bank of Kosovo) qenë pranuar anëtare të sistemit SWIFT të pagesave ndërkombëtare.

### Institucionet Financiare Jo-bankare

BPK-ja është përgjegjëse për liçencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare jo-bankare. BPK-ja, në fund të vitit 2002, pat rëxhistruar 16 institucione financiare jo-bankare të cilat merren me financa të vogëla dhe huadhënie ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme. Këto institucione financohen nga grantet e donatorëve ndërkombëtarë. Si garancë përdoren që të dyja bashkë – garancat solidare grupore dhe huatë individuale për qëllime produktive me garantues. Institucionet financiare jo-bankare po ndihmojnë në krijimin e një sistemi stabil i cili ofron shërbime financiare për grupe nevojtare dhe bizneset e vogëla që nuk kanë qasje deri të kreditë. Kreditë e lejuara nga këto institucione, në fund të vitit 2002, ishin 33 milionë euro, ndërsa një vit më parë ishin 21 milionë euro.

Sipas Rregullës nr. XVI-të të BPK-së mbi Rëxhistrimin, Liçensimin dhe Mbikëqyrjen e Byrove për Këmbime të Huaja dhe Shërbimeve për Transferta të Parasë, entitetet që operojnë si byro për këmbime valutore dhe/ose shërbimet për transferta të parasë lypset të regjistrohen në BPK si dhe të zbatojnë kërkesat operuese të cekura në këtë Rregullë. Deri në fund të vitit 2002, BPK-ja ka aprovuar aplikacionet për hapjen e tre byrove për këmbim të jashtëm dhe dy aplikacione prej entiteteve për kryerjen e shërbimeve të transfertave të parave.

### Mbikëqyrja e Sigurimeve

Sistemi i liçencimit të kompanisë së sigurimeve u bë përmes Udhëzimit Administrativ nr.1999/3 të Shtyllës së II-të të UNMIK-ut dhe prej saj qenë liçencuar pesë kompani sigurimi. Ky program i liçencimit që realizuar gjatë vitit 2000 me qëllim të shitjes së polisave të sigurimit të automjeteve. Gjatë vitit 2001, u mor vendimi mbi përgatitjen e rregullores moderne të sigurimeve dhe me ratifikimin e saj të gjitha kompanitë e sigurimeve duhej të liçencohen, rregullohen dhe mbikëqyren nga ana e BPK-së. Programi i sigurimeve në BPK startoi me katër kompani të Sigurimeve të liçencuara nga ana e Shtyllës së II-të, ndërsa, gjatë vitit 2001, një kompani e sigurimeve u tërhoq nga tregu i Kosovës.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/25 mbi Liçencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve si dhe Ndërmjetësuesve në Sigurime u nënshkrua më 5 tetor të vitit 2001 dhe me këtë u krijua një rëxhim i ri rregullativ i bazuar në parimet e Bashkimit Evropian. Kjo rregullore transferoi përgjegjësinë efektive të mbikëqyrjes dhe liçencimit të katër kompanive ekzistuese të sigurimit jo-jetë

prej Shtyllës së II-të në BPK. Kompanive ekzistuese u që lejuar operimi i përkohshëm sipas Rregullores së Shtyllës së II-të, por si atyre ashtu edhe kompanive të reja të themeluara u që kërkuar të aplikojnë në BPK për liçencë të re pune.

Katër kompanitë ekzistuese të sigurimeve, më 31 dhjetor të vitit 2001, dorëzuan aplikacionet për liçencë sipas Rregullores së re të UNMIK-ut. Bazuar në pushtetin ekzekutiv të BPK-së, të nxjerrë nga rregullorja e re e sigurimeve, një Administrator i Përkohshëm që emëruar në vend të menaxhmentit korent të një kompanie të sigurimeve. Në vijim kompania që dërguar në falimentim.

### **Qëllimi i BPK-së**

Qëllimi i BPK-së është mbrojtja e popullsinë kosovare përmes themelimit dhe zbatimit të rregullores dhe regullave - sipas të cilave industria e sigurimeve kryen funksionet e saja dhe paguan obligimet.

### **Status i Zhvillimit**

Është bërë themelimi i departamentit funksional të rregullimit të sigurimeve dhe është zhvilluar një program trajnimi. Personeli i mbikëqyrjes përbëhet nga nëntë inspektorë dhe 3 ndihmës inspektorë. Inspektorët po trajnohen përmes punës, ndërsa me qëllim të avansimit të njohurive dhe kuptimit nga ana e tyre të mbikëqyrjes së sigurimeve, janë zhvilluar edhe programe trajnimi brenda departamentit. Sa i përket menaxhmentit vendor, me emërimin e kosovarit si Rregullator të Sigurimeve - në fillim të 2003-ës, BPK-ja do të përmbush qëllimin e vet 100%. Tridhjetë rregullat prudenciale, të përgatitura dhe të aprovuara nga ana e Bordit Drejtues, japin si shpjegimet për kërkesat ligjore mbi funksionimin e të gjitha llojeve të kompanive të sigurimeve, të ndërmjetësuesve, brokerëve dhe rregullatorëve, ashtu edhe kërkesat financiare të tyre. Sot kemi 8 kompani të sigurimeve të liçencuara, ndërsa një është duke funksionuar me liçencë të përkohshme. Kompanitë e sigurimeve gradualisht kanë zgjeruar aktivitetin e tyre, ndërsa dy prej tyre tashmë funksionojnë në zona ku shtrihen minoritetet. Aktualisht, BPK-ja është duke procesuar një aplikacion për kompani të sigurimit të jetës, ndërsa ka pranuar edhe dy aplikacione të tjera.

Me qëllim të stabilizimit të mëtejshëm të industrisë së sigurimeve si dhe të edukimit të publikut kosovar dhe industrisë së sigurimeve, BPK-ja ka përkrahur formimin e Asociacionit të Sigurimeve të Kosovës dhe të Institutit për Sigurime. Gjithashtu, BPK-ja ka themeluar Fondin Garantues me qëllim të mbrojtjes së popullsisë së Kosovës nga automjetet e pasiguruara.

### **Premiumet e Lëshuara dhe Zhdëmtimet**

Katër kompanitë e sigurimeve, në vitin 2001, lëshuan gjithsej 179,864 polisa në vlerë premiumi prej 31,161,676 euro, ndërsa vlera e zhdëmtimeve të realizuara arriti në 2,655,560 euro. Në vitin 2002, tetë kompanitë e sigurimeve lëshuan gjithsej 174,967 polisa në vlerë premiumi prej 27,127,023 euro, ndërsa realizuan 7,766 zhdëmtime që kapin shumën prej 3,389,982 euro. Fondi Garantues bëri zgjidhjen e 212 kërkesave për kompenzim dëmsh që kapin vlerën prej 155,678 euro.

### **Klasat e reja të biznesit**

Janë aprovuar gjashtë klasa plotësuese biznesi për tre kompani: Zjarri, Aksidenti Personal (AP), Rreziqet Gjithsej në Ndërtimtari (RrGjN), Dëmet Fizike të Veturave (CASCO), Përgjegjësia e Drejtorëve dhe Nëpunësve (D & N) dhe Përgjegjësia Profesionale.

Për tre kompani janë aprovuar katër klasë plotësuese biznesi: Zjarri, Aksidenti Personal (AP), Rreziqet Gjisej në Ndërtimtari (RrGjN), Dëmtimet Fizike të Veturave (CASCO). Dy kompani ende merren vetëm me autopërgjegjësinë e detyrueshme.

## Memorandumet e Mirëkuptimit në Sigurimin Ndërkombëtar

BPK-ja ka nënshkruar dy Memorandume Mirëkuptimi për Sigurime të cilat do t'u lejojnë ngasësve të automjeteve nga Kosova të hyjnë në shtetet përreth, ndërsa njëri prej tyre u lejon motoristëve kosovarë që të hyjnë pa paguar Sigurimin Kufitar. Poashtu, BPK-ja është duke negociuar për marrëveshje të mëtejme bilaterale me shtetet tjera, në mënyrë që të lejohet udhëtimi ndërkufitar pa paguar sigurimin kufitar. Pritet implementim i kësaj në një të ardhme shumë të afërt.

### Politika e Investimeve

Dy Rregulla të Sigurimeve ofrojnë një politikë gjithëpërfshirëse të investimeve për kompanitë e sigurimeve. Në mungesë të strukturës dhe zhvillimit legal dhe ekonomik, BPK-ja ka kufizuar dhe ndaluar investimet në dispozicion të kompanive të sigurimeve. Investimet korente në dispozicion të kompanive të sigurimeve janë pasqyruar më poshtë:

Aktivet e lejueshme	Kufizimet	Vlersimi
Paraja e gatshme, në euro	Paraja e gatshme e imtë	Depozita e Fiksuar ose Vlera në Treg (VT)
Paraja e gatshme në valuta tjera	0	
Depozitat:		
BPK	100%	VT
Bankat tjera komerciale në Kosovë	10%	VT
Maksimumi-të gjitha bankat komerciale	30%	VT
Bankat e Jashtme të Aprovuara	10%	VT
Obligacionet:		
Qeveria – Kosovë	<i>Shënim 1</i>	VT
Qeveria – Jo-Kosovë	100%	VT
Qeveria – Jo e njohur	1%	VT
Korporatat – Aprovuar	5%	VT
Ekuitetet:		
Këmb.i letrave me vlerë- Aprovuar	5%	VT
Letrat me vlerë – Jo të njohura	1%	VT
Letrat me vlerë – Bankat e aprovuara nga BPK	5%	VT
Kreditë:		
Të sigurta – aprovuar nga BPK-ja	2.5%	VT
Të pasigurta	0	
Prona:		
Zyra e selisë dhe zyret e filialave	5%	VT
Tjera	0	
Kosovë	0	
Instrumentat Garantues të Bashkimit Evropian	<i>Shënim 2</i>	VT
Instrumentat Financiarë të BPK-së:		
Instrumentat e Depozitit të Fiksuar	100%	VT
Tjera	<i>Shënim 3</i>	VT
Investimet në Sektorin Jopublik të Kosovës	0	

*Shënim 1: Nuk është opcion për të ardhmen e afërt. Shënim 2: Opcioni po shqyrtohet. Shënim 3: Tash për tash, instrumenta të këtillë nuk ekzistojnë.*

## **Mbikëqyrja e Fondeve të Pensionit**

Departamenti i Mbikëqyrjes së Pensioneve në BPK është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/35.

Ky departament është i ngarkuar me funksionet e rregullimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve të Pensionit Suplementar Punëdhënës (Fonde Pensionale) dhe ofruesve të Pensioneve Suplementare Individuale. Poashtu, këto funksione ushtrohen edhe ndaj ofruesve të shërbimeve të entiteteve të pensioneve, përfshirë këtu Trustin e Kursimeve të Pensioneve të Kosovës, menaxherët e aktiveve dhe ruajtësit e aktiveve të pensioneve.

Departamenti i Mbikëqyrjes së Pensioneve, pranë BPK-së, që themeluar dhe organizuar më 1 qershor të vitit 2002. Tash për tash, këtë Departament e përbëjnë tre ekzaminues të pensioneve. Ekzaminuesit qenë nënshtruar trajnimit dhe vazhdojnë të trajnohen gjerësisht si mbi kornizën rregullative e legale ashtu edhe mbi shkathësitë, teknikat dhe metodologjitë të zbatuara në funksionet e plota prudenciale të pensioneve. Një këshilltar ndërkombëtar është duke ofruar asistencë teknike.

Iniciativat e para të këtij Departamenti u fokusuan në themelimin dhe zhvillimin e kapacitetit rregullativ të pensioneve lokale, i cili do të instaloj një rexhim mbikëqyrës të pensioneve në Kosovë dhe zbatojë rregullat prudenciale ngjashëm me standardet më të mira ndërkombëtare. Lidhur me këtë konstatim, në fund të dhjetorit të vitit 2002, BPK-ja ka adoptuar dhe nxjerrë 24 Rregulla mbi Pensionet dhe atë si legjislacion sekondar për implementimin e Rregullores mbi Pensionet. Gjithashtu, ky Departament liçencoi Fondet e Pensioneve të cilat ekzistojnë në se Rregullorja mbi Pensionet të hynte në fuqi. Kjo u bë me qëllim sigurimi që pagesat e bëra për përfitimin pensional si dhe autorizimet mbi pensionet të jenë të kontraktuara brenda kërkesave të Rregullores mbi Pensionet.

Plotësimi, aq sa është i nevojshëm, i rregullave ekzistuese dhe hartimi i rregullave plotësuese që i përgjigjen sistemit të pensioneve si dhe që lejojnë rritjen e sistemit brenda kornizës qeverisëse të shëndoshë e prudenciale - përbëjnë misionin e Departamentit.

BPK-ja, deri më 31 dhjetor të vitit 2002, lëshoi gjashtë liçenca të reja për Fonde Pensionale – Pensionet Suplementare Punëdhënëse. Fondet e reja rexhistruan një participim të kombinuar të 1.706 participantëve. Pritet që edhe më shumë ndërmarrje të themelojnë Fonde Pensionale për punëtorë të tyre dhe atë si një plotësim ndaj pensioneve të kursimeve individuale të obligueshme.

BPK-ja vazhdon të mbetet e përkushtuar në ndërtimin dhe forcimin e kapacitetit rregullativ dhe mbikëqyrës të pensioneve, në mënyrë që, të promovojë dhe mbështet zhvillimin dhe rritjen e shëndoshë të pensioneve brenda një rexhimi të mbikëqyrjes, të cilin e karakterizon transparenca dhe devotshmëria ndaj standardeve rregullative të shëndosha ndërkombëtarisht të pranuar.

## **Funksionet Bankare**

Funksionet bankare të BPK-së janë të grupuara në tre seksione kryesore: Menaxhimi i parasë së gatshme dhe thesarit, Shërbimet bankare dhe Sistemi i Kleringut Ndërbankar.

Kryesisht, Menaxhimi i parasë së gatshme dhe i thesarit është i preokupuar me mbajtjen e stokut adekuat të euro bankënotave dhe monedhave për nevojat e ekonomisë lokale. Ky funksion, në vitin 2002, pati një rol të theksuar gjatë kalimit në valutën euro. Personeli i thesarit të BPK-së punon me një vëllim të posaçëm të parasë së gatshme si në markë gjermane ashtu edhe në euro. Gjithashtu, përgjegjësi e tyre ishte edhe minimizimi i nevojës për transport të parasë së gatshme midis filialave dhe me këtë edhe reduktimi i kostos së përgjithshme të operacioneve me para të gatshme.

Mirëmbajtja dhe planifikimi i drejtë i rezervave të parasë së gatshme, mundësoi që BPK-ja të rris shumën e fondeve në dispozicion për investime në tregun financiar.

Përmes rrjetit të vet të filialave, BPK-ja ofroi lehtësira këmbimi për shumicën e popullsisë së Kosovës. Depozitat dhe tërheqjet e klientëve, pagesat e tatimeve dhe taksave, pagesat e doganës, pagesat e rrogave punëtorëve në sektorin publik, pagesat e ndihmës sociale dhe pensioneve dhe punët me banka dhe institucione financiare – të gjitha këto, deri në kohën kur rrjeti i saj i filialave iu dha bankave komerciale (korrik 2002), u realizuan nga ana e BPK-së. Deri në fund të këtij viti, shumica e këtyre transaksioneve vazhduan të kryhen, në shkallë dukshëm të reduktuar, nga ana e filialës së vetme të mbetur në Prishtinë. Edhe pse veprimet komerciale bankare do të pushojnë së realizuari nga ana e BPK-së, përfundimisht në shkurt të vitit 2003, shërbimet bankare do të vazhdojnë që, përmes zyrës në Prishtinë, të ofrojnë shërbime për klientët e Bankës - kryesisht për IVK-në dhe UNMIK-un.

Krahas tranzicionit gradual kah operacionet bankare me jo-të gatshme dhe rritjes së numrit të individëve dhe kompanive që bëjnë pagesa përmes sistemit bankar, nevoja për operacione me të gatshme ka rënë në mënyrë të theksuar. Kjo i mundësoi BPK-së që të transformojë operacionet e saja në ato të ngjashme që i ka një bankë qendrore. Kështu, gjatë kësaj kohe, u bë edhe më evident rëndësia e një Sistemi modern dhe efikas të Kliringut Ndërbankar, andaj përmirësimet dhe zhvillimet e mëtejme të nevojshme qenë implementuar në sistemin e kliringut ndërbankar.

## **Sistemi i Kliringut Ndërbankar**

Me qëllim të lehtësimit të punëve rreth pagesave vendore nëpërmjet sistemit bankar, në maj të vitit 2001, është themeluar Sistemi i Kliringut Ndërbankarë (SKN). Më tutje, SKN-ja pësoi transformim të madh teknologjik ku si rezultat i kësaj, që nga prilli i vitit 2002, u jetësua një transfer i plotë elektronik ndërbankar i informatës mbi pagesën. Suksesi i SKN-së reflekton si rritjen ashtu edhe kthimin e besimit në sistemin lokal bankar.

BPK-ja, jo vetëm që menaxhon dhe monitoron operacionet, por ajo gjithashtu participon drejtpërdrejtë në sistemin e pagesave në të cilin marrin pjesë të shtatë bankat komerciale lokale. Sistemi i ri ofron mjete të zhvilluara të komunikimit mes bankave, pastaj një përshtatje reale-në kohë, ndaj bilanceve të bankave me BPK-në, zvogëlim të theksuar të rreziqeve dhe kostove të ndërlidhura me pagesën dhe marrëveshjen si dhe mundësinë e ekzekutimit të pagesave shpejtë dhe në mënyrë efikase. Numërizimi standard i llogarive bankare sipas IBAN-it, është kryer me sukses në të gjitha bankat e Kosovës.

Numri dhe vlera gjithsej e transaksioneve të procesuara nga ana e SKN-së ka vazhduar të rritet gradualsiht. Numri mesatar ditor i transaksioneve të pagesave bankë me bankë, në dhjetor të vitit 2002, arriti në 640. Në janar kjo mesatare ditore ishte vetëm 40 transaksione. Përderisa shuma mesatare e transfertave të procesuar nga SKN-ja ishte thuaja e pandryshuar, shuma mujore gjithsej e fondeve të transferuara mes bankave, për periudhën e njëjtë, ngritet prej 8.6 milionë euro në 138.1 milionë euro.


Krahas pagesave normale (transferta-rexhistri bankë me bankë) dhe prioritare (numër i vogël i transfertave individuale), veprimet e SKN-së përfshijnë edhe pagesat masive. Është shënuar rritje e theksuar e këtij lloji të transfertave, si rezultat i drejtpërdrejtë të implementimit të gjerë të pagesës së rrogave drejtpërdrejtë përmes llogarive bankare. Vlersimet e BPK-së flasin se afër 200.000 pagesa të këtylla individuale janë procesuar në baza mujore.

Tarifat për anëtarim dhe transaksione – të përcaktuara nga ana e SKN-së, mbeten të pandryshuara gjatë vitit të kaluar. Me qëllim të nxitjes së mëtejme dhe rritjes së fleksibilitetit në operacionet e

pagesave, pritet që, në fillim të 2003-ës, të implementohet një strukturë e re tarifore e cila po zhvillohet në bashkëpunim të plotë me KKPN-në (Komiteti Këshillëdhënës për Pagesa Ndërbankare).

Sipas Rregullës Prudenciale të BPK-së nr.XVII, të gjitha bankat e liçencuara për veprim brenda Kosovës duhet të mbajnë llogaritë e Rezervës së Likuiditetit në BPK. SKN-ja ishte përgjegjëse për monitorimin dhe administrimin e këtyre llogarive. Gjithashtu, SKN-ja, përmes aktiviteteve të përditshme në rregullimin e llogarive të bankave, kryente edhe funksionin e ndërlidhjes midis BPK-së dhe bankave komerciale.

### Numri mujor dhe shuma e pagesave gjithsej në SKN gjatë vitit 2002



Përkundër progresit evident të arritur në vitin 2002, SKN-ja do të bëjë përmirësime të mëtejme teknologjike dhe organizative. Kjo nënkupton zhvillimin dhe implementimin e një lidhjeje direkte informuese mbi pagesën ke gjeneruesit më të mëdhenj të pagesave massive, pastaj lidhjen e plotësisht të automatizuar me sistemin intern të kontabilitetit të BPK-së si dhe përmirësimet e mëtejme në grumbullimin dhe publikimin e të dhënave statistikore mbi punën e SKN-së. Me qëllim të arritjes së potencialit të rregullimit të plotë në kohë-reale në sistemin banker të Kosovës, SKN-ja do të vazhdojë së inkurajuar bankat komerciale në zgjerimin e infrastructures së tyre komunikuese me rrjetin e tyre të filialave. Në vitin 2003 do të shqyrtohen mundësitë e zgjerimit të linqeve tashmë ekzistuese të telekomunikim të dedikuar mes BPK-së dhe pjesëmarrësve të tjerë në SKN, pastaj siguria e këtyre linjave dhe mundësia e themelimit të rrjetit elektronik.

### Operacionet e jashtme

Funksioni i BPK-së i Menaxhimit të aseteve (mjeteve financiare) të jashtme u rifokusua dhe u modernizua gjatë vitit 2002 në pajtim me strategjinë e tërësishme të rishikuar. Funksioni i saj i pagesave ndërkombëtare u zvogëluar gradualisht me kalimin e shumicës së aktiviteteve të saj komerciale te bankat komerciale lokale. Ndonëse aktivitetet e pagesave të jashtme vazhduan të kryhen nga BPK-ja, ato ishin në një nivel të zvogëluar dhe u ofroheshin kryesisht qeverisë dhe institucioneve financiare.

Shuma e fondeve nën menaxhimin e BPK-së të disponueshme për investime, pas zëvendësimit të markës gjermane me euro, u rrit dukshëm dhe BPK-ja zhvilloi marrëdhënie më të ngushta me bankat e tjera qendrore të Europës dhe e avancoi njohjen e saj. Krahas marrëdhënieve në zhvillim me bankat korrespondente në Gjermani dhe Austri, marrëdhënie të reja bankare u themeluan dhe priten të operacionalizohen në vitin 2003.

BPK-ja ishte në gjendje ta përmirësojë kthimin nga investimet përderisa respektonte rregullat e përgjithshme të shmangies nga risqet dhe mbante një likuiditet dhe një siguri adekuate të investimeve të veta. Funkzioni i Menaxhimit të riskut u zhvillua gjatë vitit 2002 dhe Menaxheri i riskut i emëruar rishtas, së bashku me Auditimin e brendshëm, do të jenë përgjegjës për vlerësimin, përcaktimin dhe përcjelljen e politikave dhe strategjive të investimeve. Ndarja e detyrave në mes të aktiviteteve afariste dhe përllogaritare vazhdoi të respektohej në mënyrë strikte.

## Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të BPK-së

### Kalimi në euro

Zyrtarizimi i përdorimit të markës gjermane në Kosovë që bërë përmes Rregullores nr.1999/04 dhe Udhëzimit Administrativ nr.1999/02. Më tutje, Udhëzimi Administrativ nr.2001/24 trasoi rrugën për zëvendësimin e markës gjermane me valutën euro si valutë me përdorim më të gjerë në Kosovë. Gjithashtu, me këtë, përgjegjësia për këtë detyrë kolosale të kalimit në valutën euro u bart të menaxhmenti dhe punëtorët e BPK-së.

Përgatitjet për kalim në valutën euro, në Kosovë, patën filluar në gusht të vitit 2000. Objektiv kryesor i BPK-së dhe i UNMIK-ut, gjatë kalimit në valutën euro, ishte që të sigurohet një kalim i lehtë dhe i sigurtë si dhe mundësisht me një kosto sa më të ultë. Për arritjen e një zgjidhjeje optimale për Kosovën, BPK-ja u lidh me FMN-në, Deutsche Bundesbank, Bankën Qendrore Evropiane, Commerzbank, Bankën Nacionale të Austrisë dhe Raiffeisen Zentral Bank. Kjo përfshiu vlersimin teknik dhe përcaktimin e nevojave si dhe përgatitjeve për skenarët e kalimit në valutën euro. Edhe pse kalimi kryesor në valutën euro ishte i thjeshtë, shkalla dhe konsideratat teknike të vetë operacionit diktuan nevojën për involvimin e shumë agjencive qeveritare, KFOR-it dhe të ndërmarrjeve komerciale.

Në mungesë të të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse nuk ishte i mundshëm vlersimi i saktë i markës gjermane në qarkullim në Kosovë. Bazuar në informatat në dispozicion dhe analizat e posaçme të tregut u vlersua se për finalizimin e kalimit në valutën euro, deri më 28 shkurt 2002, lypset importuar 500 milionë euro. Furnizimi me euro bankënota dhe monedha, në Kosovë, filloi në fillim të dhjetorit të vitit 2001. Me qëllim të furnizimit të bankave komerciale lokale dhe plotësimit të nevojave të vetë BPK-së, në Kosovë, u sollën rreth 100 milionë euro qysh para fundit të vitit 2001. BPK-ja, si pjesë të punëve parapërgatitore, përmes tenderit ndërkombëtar, ftoi kompanitë për TNV (Transport Ndërkombëtar të Valutave) që të ofrojnë paratë dhe transportin e euros.

Për dallim prej shteteve të euro-zonës, ku të gjitha bankat, me qëllim të ndërrimit të valutave të tyre nacionale në euro pa kurrfarë provigjioni - gëzuan qasje direkte ke bankat qendrore emetuese, në Kosovë, paraja e gatshme euro duhej të silllej nga bota e jashtme. Aq më tepër, bankënotat dhe monedhat e mbledhura të markës gjermane, duhej të riatdhesosheshin pas ndërrimit. Kjo involvoi kosto të konsiderueshme transporti, sigurimi dhe sigurie.

Të gjitha bilancet në DEM, të mbajtura në llogaritë e BPK-së dhe të bankave komerciale lokale në Kosovë, më 1 janar 2002, qenë konvertuar automatikisht dhe pa kurrfarë provigjioni në euro dhe atë me një normë të parevokueshme konvertimi prej 1.95583 DEM për një euro.

Gjatë janarit dhe shkurtit të viti 2002 (periudha e qarkullimit paralel) ishin të akceptueshme për pagesa si bankënotat dhe monedhat DEM ashtu edhe ato në euro. Në të njëjtë kohë, ndërrimi fizik i markave gjermane me euro u realizua sipas këtyre kushteve vijuese:

- Shumat deri në 1,000 DEM (shuma familjare) u këmbyen pa kurrfarë provigjioni,
- Shumat deri në 10,000 DEM iu nënshtruan provigjionit,
- Shumat mbi 10,000 DEM qenë pranuar vetëm si depozita në banka.

Kalimi në valutën euro ofroi një rast unik për zvogëlimin e parasë së gatshme në qarkullim dhe, duke inkurajuar kalimin prej sistemit ekzistues të pagesave me para të gatshme në atë me jo të gatshme, ndikoi në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit bankar modern dhe efikas. Përmes publikimit të limiteve mbi shumat e këmbyeshme dhe përkushtimit të vendosur ndaj afatit të qarkullimit paralel, poseduesit

e parave të gatshme qenë inkurajuar që të hapin llogari bankare dhe të depozitojnë paratë e tyre në banka.

Roli që fushata informative publike pati në kalimin e suksesshëm në valutën euro nuk mund të lihet i panëvizuar. Ky rol u zhvillua me ndihmën e Agjencionit Evropian për Rindërtim dhe UNMIK-ut, ndërsa u realizua përmes Odës Ekonomike dhe mbështetjes nga ana e Qendrës Evropiane Informative Korresponduese. Falë partneritetit me Shtyllën e IV-të të BE-së, broshurat dhe publikimet tjera qenë shpërndarë nëpër tërë territorin e Kosovës. Më shumë se 300,000 kopje të broshurave qenë shtypur dhe shpërndarë dhe atë në tri gjuhë zyrtare – shqipe, serbe dhe angleze.

### **Importi & Eksporti i parasë së gatshme në vitin 2002 - BPK dhe Bankat Komeriale** (përfshirë furnizimin me euro në dhjetor të vitit 2001)

	<b>Importi (euro)</b>	<b>Eksporti (euro)</b>	<b>Riatdhesimi (DEM)</b>
BPK	455,212,500	45,000,000	1,027,268,819
Bankat Komeriale	142,200,000	61,211,407	151,634,126
<b>Gjithsej</b>	<b>597,412,500</b>	<b>106,211,407</b>	<b>1,178,891,095</b>

Furnizimi me euro monedha dhe importi i mëvonshëm plotësues i tyre arriti në rreth 7 milionë euro. Gjithashtu, BPK-ja riatdhesoi DEM monedha në vlerë prej gjithsej 9.67 milionë DEM. Këto detyra kërkonin organizim dhe planifikim logjistik sinjifikant, kështuqë është dashur që të transportohen më tepër se 100 tonelata monedha.

### **Rrjeti i Filialave të BPK-së**

Në kohën kur u themelua BPK-ja (nëntor 1999), në Kosovë nuk funksionote asnjë bankë tjetër. Për këtë, ajo ofroi lehtësira dhe shërbime bankare për administratën e UNMIK-ut dhe të gjitha komunitetet në Kosovë. Atëbotë, ishte paraparë që, kur sistemi i bankave komerciale të ketë arritur një zhvillim të mjaftueshëm, atëherë, të gjitha funksionet komerciale të BPK-së do të transferoheshin në sistemin e bankave komerciale. Ky objektivi u realizua në vitin 2002. BPK-ja hoqi dorë nga rrjeti i saj i filialave (gjashtë filiala dhe 15 nën-filiala) dhe me këtë një pjesë substanciale e funksionit të pagesave, në vitin 2002, kaloi në bankat komerciale. Ky program u kompletua me nënshkrimin e marrëveshjes së fundit mbi qiradhënien më 8 korrik. Pas kësaj ndarjeje, numri i punëtorëve të BPK-së, në vitin 2002, u zvogëluar nga 362 (sa kishte në janar) në 127 (në fund të korrikut). Pjesë e këtyre marrëveshjeve mbi qiradhënien ishte edhe transferimi i stafit ekzistues në bankat që morën objektet me qira, kështuqë me këtë filialat qenë mbyllur në mënyrë efektive dhe pa humbje të vendeve të punës. Mbyllja e veprimtarisë së filialave rezultoi me një reduktim të të hyrave të BPK-së për 60%. Marrëveshjet mbi qiradhënien e objekteve të filialave, për të cilat BPK-ja ka përgjegjësinë e mirëmbajtjes, gjeneruan të hyra në shumë prej 175,000 euro. Sidoqoftë, këto të hyra nuk janë ende në dispozicion të BPK-së në formë të të hyrave të saj, për shkak se janë të deponuara në llogarinë speciale të mirëbesimit deri atëherë kur të zgjidhet e drejta pronësore mbi këto objekte.

### **Zhvillimi i Burimeve Njerëzore**

Përveq funksioneve administrative brenda BPK-së, Departamentit të Burimeve Njerëzore i është caktuar edhe përgjegjësia e përparimit të diturive dhe shkathësive të personelit të BPK-së. Me qëllim koordinimi të programeve të ndryshme trajnuese në vijim e sipër si dhe avansimin e përpjekjeve

trajnuese, u krijua një vend pune për Nëpunës të Trajnimeve brenda këtij Departamenti. BPK-ja është ende organizatë e re, kështuqë puna dhe ambienti në të cilin ajo funksionon janë subjekt të ndryshimeve të vazhdueshme. E tërë kjo shtrun kërkesa sinjifikante për personelin e BPK-së i cili duhet të ecën krah për krah me zhvillimet si dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të qenë prijës i ligës së diturisë në sektorin financiar.

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka hartuar plane gjithëpërfshirëse aftagjata trajnimi dhe poashtu është pajisur mirë për t'iu përgjigjur shpejtë të gjitha nevojave të papritura. Ky departament, në bashkëpunim me menaxherët e të gjitha departamenteve si dhe përmes praktikës së trajnimit të secilit nivel të punëtorëve, vazhdimisht përcakton nevojat për trajnime dhe zhvillim profesional të personelit – krejt kjo me qëllim të ndërtimit të një organizimi efikas, të cilësisë së lartë dhe të kostos efektive.

Programet arsimuese mbi punën të BPK-së startuan me trajnimin e strukturuar dhe të mbikëqyrur në procesin e punës. Janë organizuar kurse “brenda shtëpisë” për grupe të punëtorëve në pozita të ngjashme. Lidhur me nevojat trajnuese të specializuara ose individuale, punëtorët e BPK-së morën pjesë në seminare të institucioneve si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

Si shtojcë e kësaj vijnë edhe seminarët e organizuara në informimin e krejt personelit mbi rregulloret e reja, ligjet dhe çështjet tjera si për shembull sigurimi shëndetësor dhe pensional. Me qëllim përmirësimi të shkallëve të aftësisë së krejt menaxherëve lokal, është bërë trajnimi nga lëmi i teknikave të menaxhimit, etikës në punë dhe punës ekipore.

BPK-ja, në tremujorin e fundit të vitit 2002, aranzhoi kursin e gjuhës angleze për tërë personelin e saj dhe filloi të mbështes financiarisht studimet e kohëpaskohshme si dhe ato postdiplomike në Universitetin e Prishtinës. Personeli i BPK-së ka vazhduar së përfituari nga trajnimet e sponsoruara nga ana e FMN-së në Washington dhe Vienë, nga kontaktet me funksionet analoge në Ministrinë për Financë dhe Ekonomi (MFE) dhe vizitat tjera bankave qendrore në regjion. Bashkarisht me Entin Statistikor të Kosovës (ESK) është themeluar një grup këshillëdhënës – krejt kjo me qëllim të ndërmarrjes së Analizave Makroekonomike, pastaj të përmirësimit dhe azhurimit të grumbullimit të të dhënave statistikore si dhe identifikimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. Personeli ka vijuar seminarët mbi zbulimin e parave të falsifikuara në BQE në Frankfurt dhe ACE programin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Ekonometrisë në Universitetin e Amsterdimit. Gjithashtu, disa nga punëtorët e BPK-së kanë vijuar kurset e kontabilitetit të organizuara nga ana e Bordit të Kontabilistëve të Kosovës.

## **Bartja e Përgjegjësisë të Menaxhimit**

Efektivisht që nga 1 janari i vitit 2003, roli i Ekspertëve Ndërkombëtarë do të ndryshojë në atë të Këshilltarëve. Ata do të mbështesin dhe zhvillojnë më tutje lëmitë funksionale relevante ku puna nuk është kompletuar ende, ose ku mungesat ekzistuese të prolonguara kërkojnë punë akademike ose trajnim të jashtëm. Të gjitha pozitat menaxheriale do të kenë zëvendës menaxherët e tyre lokal dhe përgjegjësitë e punëve të përditshme do të barten substancialisht te ta.

Pas mbylljes së filialave, BPK-ja filloi punën në ridefinimin e rolit të saj, ndërsa në vijë me strategjinë e korporatës, Bordi i Guvernatorëve aprovoi strukturën e rishqyrtuar organizative të BPK-së më 29 korrik të vitit 2002. Duke identifikuar kërkesat për 138 vende të punës, struktura e re është shumë e ngjashme me atë të funksioneve të Bankës Qendrore. Kjo njohu nevojën e investimit në personel dhe në zhvillimin e tij profesional në mënyrë që t'u mundësojë ecjen në hap me ndryshimet e mundshme në sektorin financiar. Pas arritjes deri ke struktura organizative e rishqyrtuar, janë bërë të gjitha përpjekjet për ripozicionimin e personeli ekzistues në vendet e zbarzëta duke u përkushtuar, në të

njëjtë kohë, për investim në zhvillimin e tyre profesional. Me ndihmën e këshillëtarëve të FMN-së, në shtator të vitit 2002, është bërë hartimi dhe implemtimi i strukturës së re të politikës së personelit dhe gradimit të tij, të rrugës së përparimit në karrierë dhe të rrogave.

Prioritet i lartë iu dha trajnimit dhe zhvillimit të personelit, ndërsa aty ku u identifikuan zbrastësira aftësish, aty edhe u zhvilluan programe trajnimi të jashtëm, "brenda shtëpisë" dhe përbrenda vetë procesit të punës. Me qëllim të trajnimit të shpejtuar dhe përgatitjes së tyre për emëtime të ardhshme menaxheriale, BPK-ja bëri zgjedhjen e dhjetë punëtorëve të rinj në mesin e personelit të saj. Gjithashtu, BPK-ja lansoi edhe një program bashkëpunimi intern për studentët më të mirë nga Universiteti i Prishtinës në mënyrë që për nevojat e saja të gjejë kandidatët më të mirë të diplomuar.

## **Implementimi i Planit Suplementar të Pensionit në BPK**

Bordi i Guvernatorëve të BPK-së, më 18 dhjetor të vitit 2002, ka aprovuar dhe adoptuar vendimin mbi krijimin e e Fondit Pensional të BPK-së. Pensioni i BPK-së do të jetë një shtesë në privilegjet tjera të cilat një i punësuar do t'i marrë me rastin e pensionimit. Kështu, kur një punëtor i BPK-së pensionohet në moshën 65 vjeçare, atëherë ai ose ajo mund të llogaris në një fluks modest të hyrash të siguruara nga ana e pensionit jetësor mujor i nxjerrë nga Pensioni Themelor si dhe në pagesë të anuitetit nga kursimet të cilat do të akumulohen në Planin e Pensionit Mandator, ndërsa më tutje, do të jetë i stimuluar me një shumë të pensionit mujor të siguar nga ana e Planit të Pensionit të BPK-së.

Plani Pensional i BPK-së nxitë pagesën e anuitetit prej Skemës së Pensioneve Mandatore. Ky Plan integron përfitimet e garantuara pensionale me atë të pagesave të anuitetit, kështuqë asnjë i punësuar në BPK, me rastin e pensionimit për tërë jetën, nuk do të merrë më pak se 45% të pensionit të tij/saj të bazuar në rrogën mujore. Plani Pensional është i llojit jo-kontribues, që do të thotë se të gjitha kontributet e kërkuara për parafinancim të privilegjave pensionale vijnë nga ana e BPK-së.

Fondi Pensional i BPK-së është i organizuar nën trustin e pavarur menaxhues të Bordit të Drejtorëve të Fondit Pensional. Bordi pesëanëtarësh i Drejtorëve përfaqëson si BPK-në (2) ashtu edhe punëtorët/participantët (3). Përfaqësuesit e punëtorëve në Bord qenë zgjedhur nga ana e participantëve në Fond, ndërsa përfaqësuesit e BPK-së në këtë Bord, qenë emëruar nga ana e menaxhmentit të BPK-së.

Fondi Pensional i BPK-së dhe Plani Pensional i BPK-së filluan me punën e tyre të pavarur efektivisht me 1 janar të vitit 2003.

# Pasqyrat Financiare të BPK-së për vitin 2002

## Informatë e përgjithshme lidhur me Pasqyrat Financiare

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ("BPK") është një entitet publik i veçantë me autoritet që të liçencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare në territorin e Kosovës. BPK-ja është themeluar në përputhje me dispozitat e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("UNMIK") - Rregullorja nr.1999/20 e nxjerrë më 15 nëntor 1999 (gjithashtu e amendamentuar më 1 tetor 2001) - "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës". Objektivat kryesorë të BPK-së, sipas kësaj Rregulloreje, janë:

- Promovimi i një sistemi të sigurtë dhe efikas të pagesave vendore dhe,
- Përkujdesja mbi likuiditetin, bonitetin dhe funksionimin efikas të sistemit financiar të bazuar në ekonominë stabile të tregut, përfshirë këtu rregullimin e bankave, kompanive të sigurimeve dhe institucioneve tjera financiare.

BPK-ja ka këtë pushtet specifik vijues, që të:

- Rekomandojë udhërrëfime të gjera të politikave për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara nga lëmitë nën përgjegjësinë e tij dhe atë duke u bazuar në udhëzimet e Zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Zhvillim dhe Rindërtim Ekonomik;
- Formulojë dhe zbatojë masat, pastaj rregullojë dhe mbikëqyrë, sistemet e marrëveshjes dhe të pagesave mbi transaksionet në valutë vendore dhe të huaj në Kosovë;
- Posedojë ose funksionojë një ose më shumë sisteme të pagesave;
- Veprojë si bankierë i Autoritetit Qendror Fiskal dhe të ofrojë këshillë financiare në kërkesë të tij;
- Veprojë si agjent fiskal i Autoritetit Qendror Fiskal;
- Mbajë në valutë të huaj depozitat e bankave, Autoriteti Qendror Fiskal dhe entiteteve tjera;
- Sigurojë furnizim adekuat të bankënotave dhe monedhave për kryerjen e transaksioneve në të gatshme;
- Mirëmbajë depozitimin për ruajtje të sigurtë të valutës dhe letrave me vlerë;
- Liçencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;
- Mbikëqyrë dhe rregullojë dilerët në këmbimin e jashtëm, dhe
- Kryejë analiza të rregullta monetare e ekonomike të ekonomisë së Kosovës, publikojë këto rezultate dhe në bazë këtyre analizave të parashtrijë propozime dhe masa para Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

BPK-ja funksionon përmes zyrës së saj qendrore të locuar në Prishtinë. Si pjesë e ristrukturimit të saj, gjatë korrikut të vitit 2002, filialat e BPK-së, përmes procedurës së tenderit, qenë marrë me qira nga ana e bankave komerciale.

## Përbërja e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues përcakton politikat për funksionimin e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe mbikëqyrë implementimin e tyre. Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut , Bordi është i përbërë nga shtatë anëtarë të emëruar nga ana e Perfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, më 31 dhjetor të vitit 2002 përbëhej nga këta anëtarë:

Zotëriu Ajri Begu, Kryetar i Pleqësisë së Bordit Drejtues  
Zonja Chaiha Kim Rhee, Drejtor i Përgjithshëm i BPK-së  
Zotëri David Weatherman, Zëvendës Drejtor për Mbikëqyrje të Sektorit Financiar  
Zotëri Benoit Waelkens, Zëvendës Drejtor për Funksionet Financiare  
Zotëri Andy Bearpark , Zëvendës i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm  
Zotëri Gazmend Luboteni, Zëvendës i Dekanit të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë  
Zbrazët (1 pozitë)

## Raporti i Auditorit të Pavarur

Ne kemi audituar bilancin e bashkangjitur të gjendjes së Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) deri më 31 Dhjetor 2002 dhe pasqyrat përkatëse mbi të hyrat, ndryshimet në kapitalin e paguar dhe rezerva si dhe rrjedhën e parasë së gatshme në përfundim të vitit 2002. Këto pasqyra financiare bien mbi përgjegjësinë e menaxhmentit të BPK-së. Bazuar në auditimin tonë, ne kemi përgjegjësi për të shprehur një mendim mbi pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare të BPK-së, përfundimisht më 31 dhjetor 2001, ishin të audituara nga një auditor tjetër, raporti i të cilit, i datuar më 4 tetor 2002, shprehte një mendim të pakualifikuar mbi këto pasqyra financiare.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Auditim. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe bëjmë auditimin në mënyrë që të arrijmë deri të një siguri e arsyeshme se këto pasqyra financiare janë të liruar nga keprezantimi material. Një auditim përfshinë ekzaminimin në baza testuese, dëshminë që mbështet shumat dhe hapjet në pasqyrat financiare. Gjithashtu, një auditim përfshinë konsideratën mbi parimet e përdorura të kontabilitetit dhe vlersimeve sinjifikante të bëra nga ana e menaxhmentit si dhe vlersimin e përgjithshëm të prezantimit të pasyrave financiare. Ne besojmë se auditimi ynë jep bazë të arsyeshme lidhur me mendimin tonë.

Duke respektuar të gjitha materialet, sipas mendimit tonë pasqyrat financiare prezantojnë në mënyrë korrekte pozitën financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës më 31 Dhjetor 2002 dhe rezultatet e funksionimit të saj, ndryshimeve në kapitalin e paguar dhe rezerva dhe rrjedhat e parasë së gatshme si dhe janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përfshirë këtu Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Pa e kualifikuar mendimin tonë, ne u tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se, tash për tash, ekziston pasiguri në Kosovë e cila rrethon drejtimin e ardhshëm të mundshëm të politikës ekonomike vendore, politikës rregullative dhe zhvillimeve politike. Ne s'kemi mundësi të parashohim se cilat ndryshime në kondita do të ndodhin dhe çfarë efekti këto mund të kenë në pozitën financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

## Bilanci i gjendjes i BPK-së më 31 dhjetor 2002

	<i>Shënim</i>	<u>2002</u> (EUR '000)	<u>2001</u> (EUR '000)
<b>Aktivet</b>			
Paratë në dorë		17,474	196,132
Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente	3	65,321	99,379
Llogaritë e depozitave me bankat jorezidente	4	262,696	46,016
Prona, instalime dhe pajisje (neto)	5	621	734
Aktivet tjera	6	<u>36</u>	<u>677</u>
<b>Aktivet gjithsej</b>		<u><b>346,148</b></u>	<u><b>342,938</b></u>
<b>Pasivet</b>			
Nga bankat vendore	7	46,235	219,193
Nga institucionet qeveritare	8	268,869	79,622
Nga entitetet publike dhe komerciale	9	19,326	14,485
Pasivet tjera vendore	10	<u>1,782</u>	<u>23,139</u>
<b>Pasivet gjithsej</b>		<u><b>336,212</b></u>	<u><b>336,439</b></u>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Fondi ligjor	11	2,556	2,556
Fondi rezervë	12	<u>7,380</u>	<u>3,943</u>
<b>Kapitali dhe rezervat gjithsej</b>		<u><b>9,936</b></u>	<u><b>6,499</b></u>
<b>Pasivet dhe kapitali e rezervat gjithsej</b>		<u><b>346,148</b></u>	<u><b>342,938</b></u>

Bazuar në llogaritë ligjore të parafrazuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese janë nënshkruar dhe aprovuar, në emër të Bordit Drejtues, nga ana e:

**Chaiha Kim Rhee**  
Drejtor i Përgjithshëm

**Hysni Rudi**  
Shef i Departamentit të  
Kontabilitetit

**Benoit Waelkens**  
Zëvendës i Drejtorit të  
Përgjithshëm

Pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve të BPK-së, fundviti, 31 dhjetor 2002

	<i>Shënim</i>	<u>2002</u> (EUR '000)	<u>2001</u> (EUR '000)
Të hyra nga kamata		6,765	2,828
Shpenzime nga kamata		<u>(3,044)</u>	<u>(240)</u>
<b>Të hyra nga kamata (neto)</b>		3,721	2,588
Të hyra nga tarifa dhe provigjioni		3,041	3,392
Shpenzime nga tarifa dhe provigjioni		<u>(184)</u>	<u>(197)</u>
<b>Të hyra nga tarifa dhe provigjioni (neto)</b>		2,857	3,195
<b>Të hyra nga grantet</b>	<i>10</i>	2,860	566
<b>Të hyra tjera nga veprimtaria</b>	<i>13</i>	<u>369</u>	<u>125</u>
<b>Të hyra nga veprimtaria (neto)</b>		9,807	6,474
<b>Shpenzimet e tjera jo-operuese</b>			
Shpenzimet e personelit	<i>14</i>	929	816
Amortizimi		329	215
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	<i>15</i>	4,775	3,052
Shpenzimet tjera		<u>337</u>	<u>25</u>
<b>Shpenz. tjera jo-operuese gjithsej</b>		<u>6,370</u>	<u>4,108</u>
<b>Profiti për periudhën (neto)</b>		<u>3,437</u>	<u>2,366</u>

Bazuar në llogaritë ligjore të parafrazuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese janë nënshkruar dhe aprovuar, në emër të Bordit Drejtues, nga ana e:

**Chaiha Kim Rhee**  
Drejtor i Përgjithshëm

**Hysni Rudi**  
Shef i Departamentit të  
Kontabilitetit

**Benoit Waelkens**  
Zëvendës i Drejtorit të  
Përgjithshëm

Pasqyrë e BPK-së mbi rrjedhën e parasë së gatshme, fundviti, 31 Dhjetor 2002

	<i>Shenim</i>	<u>2002</u> (EUR '000)	<u>2001</u> (EUR '000)
<b>Rrjedha e keshit nga aktivitetet operuese</b>			
Profiti për periudhën (neto)		3,437	2,366
<b>Zërat në jo-të gatshme në pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve</b>			
Amortizimi		329	215
Të hyra nga grantet	<i>10</i>	(2,860)	(566)
<b>Ndryshimi në aktivet operuese</b>			
Rritje në llogaritë depozituese me bankat e huaja		(216,680)	(511)
(Rritje)/Zvogëlim në aktivet tjera vendore		641	(270)
<b>Ndryshim në pasivet operuese</b>			
(Zvogëlim)/Rritje nga bankat vendore		(172,958)	202,650
Rritje në shuma nga institucionet qeveritare		189,247	57,083
Rritje/(Zvogëlim) në shuma nga entitetet publike dhe komerciale		4,841	(2,842)
(Zvogëlim)/Rritje në pasivet tjera vendore		<u>(21,106)</u>	<u>21,254</u>
<b>Para e gatshme neto nga aktivitetet operuese</b>		(215,109)	279,379
<b>Rrjedhë e parasë së gatshme nga aktivitetet investive</b>			
Blerje e aktiveve fikse materiale		<u>(216)</u>	<u>(447)</u>
<b>Para e gatshme neto e përdorur në aktivitetet investive</b>		(216)	(447)
<b>Rrjedhë e parasë së gatshme nga aktivitete financimi</b>			
Kapitali i angazhuar		-	-
Fondet e granteve të pranuar		<u>2,609</u>	<u>783</u>
<b>Para e gat. (neto) nga aktivitete financimi</b>		2,609	783
<b>(Zvogëlim)/Rritje në para të gat. dhe ekuival. me para të gat. për periudhën</b>		(212,716)	279,715
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalente me paranë e gatshme në fillim të periudhës</b>		<u>295,511</u>	<u>15,796</u>

Pasqyrë e ndryshimeve në Kapitalin e Paguar dhe Rezerva, fundviti, 31 Dhjetor 2002

	<u>Kapitali</u> (EUR' 000)	<u>Rezerva e përgjithshme</u> (EUR '000)	<u>Përfitimet e mbajtura</u> (EUR '000)	<u>Gjithsej</u> (EUR '000)
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2000</b>	2,556	309	1,268	4,133
Profiti për vitin (neto)	-	-	2,366	2,366
Transfer në fondin rezervë	_____ -	<u>3,634</u>	<u>(3,634)</u>	_____ -
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2001</b>	<u>2,556</u>	<u>3,943</u>	_____ -	<u>6,499</u>
Profiti për vitin (neto)	-	-	3,437	3,437
Transfer në fondin rezervë	_____ -	<u>3,437</u>	<u>(3,437)</u>	_____ -
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2002</b>	<u>2,556</u>	<u>7,380</u>	_____ -	<u>9,936</u>

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së

### 1. BAZA E PREZANTIMIT

Këto pasqyra financiare të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës ("BPK") janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS"), përfshirë këtu Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga ana e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, ndërsa mospërfshirë këtu pagat e financuara nga donatorët, të cilat nuk janë regjistruar si shpenzime, dhe të hyrat nga grantet në pasqyrat financiare të BPK-së.

#### **Valuta e prezantimit**

Pasqyrat financiare të BPK-së, deri më 31 Dhjetor 2002, ishin të prezantuara në valutën zyrtare për territorin e Kosovës, ku marka gjermane ("DEM") ishte valutë matëse dhe raportimi në territorin e Kosovës. Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/4, që nga 1 Janari 2002, euro ("EUR") është adoptuar si një nga valutat zyrtare në Kosovë, ku si pasojë e kësaj shumat e denominuara në DEM qenë konvertuar në EUR qysh nga 1 Janari 2002 dhe atë duke zbatuar një normë këmbimi të fiksuar dhe të parevoikueshme 1 EUR=1.95583 DEM. Që nga 1 Janari 2002 librat e BPK-së dhe evidencat mbahen në EUR.

#### **Bazat e kontabilitetit**

BPK-ja mirëmban evidencat e saja të kontabilitetit në përputhje me praktikën e përgjithshme të kontabilitetit të akceptuar në territorin e Kosovës së administruar nga Kombet e Bashkuara dhe përgatit pasqyrat e saja financiare në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

Pasqyrat financiare të Bankës janë të përgatitura sipas konvencës së kostos historike.

#### **Përdorimi i vlerësimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë vlerësime dhe syzozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe pasiveve dhe hapjen e aktiveve dhe pasiveve të rezervuara (kontigjenciale) në datë të caktuar të pasqyrave financiare dhe në shumat e raportuara të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportuar. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme prej vlerësimeve të tilla.

#### **Riklasifikimi i shumave krahasuese**

Aty ku ka qenë e domosdoshme dhe me qëllim që të jenë konforme me ndryshimet në prezantimin e vitit vijues, është bërë korigjimi i shumave krahasues.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME TE KONTABILITETIT

#### **Kamata dhe komisionet**

Të hyrat dhe shpenzimet nga kamata, në këto pasqyra financiare, janë të njohura në baza përlogaritëse.

E hyra nga komisionet i është kredituar të hyrave, atëherë kur shpenzimi i komisionit të pranuar i është debituar shpenzimit kur është paguar.

#### **Konvertimi i valutave të huaja**

Transaksionet e denominuara në valutë të huaj janë konvertuar në EUR sipas normës së këmbimit zyrtar të Bankës në datën e transaksionit.

Aktivet dhe pasivet monetare në valutë të huaj janë rikonvertuar në EUR sipas normës së këmbimit zyrtar të Bankës në fund të periudhës së raportimit të pasqyrave financiare. Përfitimet/humbjet e perealizuara në këmbimin e jashtëm janë kredituar/ngarkuar në pasqyrën e të hyrave.

Normat e aplikueshme zyrtare të Bankës (EUR kundruall njësisë së valutës së huaj) për valutat kryesore më 31 Dhjetor ishin si vijon:

	31 Dhjetor 2002	31 Dhjetor 2001
Dollari i Shteteve të Bashkuara ("USD")	0.938	1.060
Franku i Zvicrës ("CHF")	0.674	0.661
Funta Angleze ("GBP")	1.502	-

#### **Paraja e gatshme dhe ekuivalencat e parasë së gatshme**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja e gatshme dhe ekuivalencat e parasë së gatshme përfshijnë paranë e gatshme në dorë dhe llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente.

#### **Prona, instalimet dhe pajisjet**

Kur ka qenë e domosdoshme, prona, instalimet dhe pajisjet janë pasqyruar në kosoton historike të zvogëluar për amortizimin e akumuluar dhe provigjionin për dëmtimet.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME TE KONTABILITETIT (vazhdim)

Nëse vlera korrekte e nje pjese të pronës, instalimit dhe pajisjes është më e ultë se shumta e mbajtjes së saj, nisur nga rrethanat jo të konsideruara për të qenë gjë e përkohshme, atëherë pjesa e pronës, instalimit dhe pajisjes është zhvlerësuar sipas vlerës së saj korrekte.

Përfitimet dhe humbjet nga dëmi në pronë, instalim dhe pajisje janë pranuar në pasqyrën e të hyrave në vitin kur ka ndodhur dëmi.

Amortizimi në të gjithë pronën, instalimin dhe pajisjen është siguruar në bazë të kostos historike. Ngarkimi vjetor për amortizimin është llogaritur duke përdorur metodën e drejtpërdrejtë dhe duke përdorur shkallët e specifikuar për secilin mjet të amortizueshëm bazuar në kohëzgjatjen e vlersuar të shfrytëzimit. Kohëzgjatjet e vlersuara të shfrytëzimit, të zbatuara gjatë vitit - deri në fund të 31 dhjetorit 2002 dhe periudhës së mbaruar më 31 dhjetor 2001, janë si vijon:

	Shkalla vjetore e amortizimit	Kohëzgjatja e shfrytëzimit
Veturat	20%	5 vite
Instalime, zyrë dhe pajisje tjera	20%	5 vite
Pajisje kompjuterike	33.3%	3 vite

#### **Të hyrat nga grantet**

Grantet e pranuar me qëllim të blerjes së pronës, instalimit dhe pajisjes ose prona, instalimi dhe pajisja e dhuruara janë evidentuar në bilancin e gjendjes si të hyra nga grantet të shtyera dhe janë liruar nga të hyrat prej granteve gjatë kohës së njëjtë të kohës së shfrytëzimit të pronës, instalimit dhe pajisjes. Grantet e pranuar për financimin e shpenzimeve të BPK-së janë kredituar direkt ke të hyrat nga grantet në pasqyrën e të hyrave në kohën kur shpenzimi në fjalë edhe ka ndodhur.

#### **Aktivitetet fiduciare**

Nës disa raste specifike Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vepron si agjent fiskal dhe si agjent i pagesave të Autoritetit Qendror Fiskal (nga 1 janari 2003: Ministri për Financë dhe Ekonomi). Aktivitetet dhe të hyrat e realizuara nga aktivitetet e tilla janë përjashtuar nga këto pasqyra financiare ku Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vepron me kapacitet fiduciar siq është nominimi ose agjenti.

#### **Vlera korrekte e instrumenteve financiare**

Vlera korrekte është shumta në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në transaksionin korent midis dy palëve të gatshme, përjashtuar shitjen e detyruar ose likuidimin, dhe më së miri është e evidentuar përmes çmimit të kuotuar në treg.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 2 PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME TE KONTABILITETIT (vazhdim)

Aktivitet afatshkurtëra të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës janë të përfshira në pasqyrat financiare në çmimin i cili i afrohet vlerës së tyre reale sepse këta instrumenta kanë afat të shkurtër të skadimit dhe janë të konvertueshëm në para të gatshme dhe të realizueshëm pa ndonjë kosto të rëndësishme transaksioni.

#### **Tatimimi dhe shpërndarja e profitit**

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/20, "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës", e nxjerrë më 15 Nëntor 1999 (e plotësuar më 1 Tetor 2001), Banka është liruar nga tatimi dhe është e thirrur sipas ligjit që të paguaj direkt në Autoritetin Qendror Fiskal ("AQF"), pas alokimeve për rimbushjen e shkallëve të fondeve rezervë të udhëhequr nga Bordi Drejtues, çfardo bilanci të të hyrës së saj neto.

#### **Rezerva e Përgjithshme**

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/20 (dhe të amendamentuar), BPK-ja, për çdo vit, duhet të shpërndajë të hyrat neto në llogarinë e rezervës së përgjithshme deri sa llogaria e kapitalit dhe rezervës së përgjithshme të arrijë 5% e agreguar të shumës së bilanceve kreditore të të gjitha llogarive, të mbajtura në librat e Bankës, nga poseduesit e llogarive të pasqyruar në bilancin e gjendjes së BPK-së në fund të secilit vit financiar.

### 3. LLOGARITE RRJEDHESE ME BANKAT JOREZIDENTE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
Deutsche Bundesbank	65,028	98,848
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	77	269
Commerzbank AG	150	246
Den Norske Bank	-	5
Dresdner Bank	<u>66</u>	<u>11</u>
Gjithsej	<u>65,321</u>	<u>99,379</u>

Kryesisht, llogaritë rrjedhëse që mbahen me bankat e huaja janë të denominuara në EUR. Llogaritë rrjedhëse më 31 Dhjetor 2002, të mbajtura në Dresdner Bank sjellin kamatë prej 1.53%, ato në Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG 2.01% (më 31 Dhjetor 2001 ishte 2.35%) dhe në Deutsche Bundesbank sjellin një kamatë prej 1.75% (më 31 Dhjetor 2001 ishte 2.35%)

Nisur nga konvertimi në EUR, BPK-ja pat ofruar një kolateral prej 193,329 mijëra DEM (si bilanc i saj me Deutsche Bundesbank) si garancion për shumën ekuivalente prej 98,848 mijëra EUR dhe si pjesë e furnizimit me EUR bankënota dhe monedha të distribuara nga ana e Deutsche Bundesbank më 8 Dhjetor 2001. Shumës së garantuar i skadoi afati më 2 Janar 2002, kur EUR bankënotat dhe monedhat u bënë valutë zyrtare.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 4. LLOGARITE E DEPOZITAVE ME BANKAT JOREZIDENTE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	104,378	42,949
Commerzbank AG	48,852	2,045
Dresdner Bank	<u>109,466</u>	<u>1,022</u>
Total	<u>262,696</u>	<u>46,016</u>

### 5. PRONA, INSTALIMET DHE PAJISJET

	Instalimet dhe pajisje tjera (EUR '000)	Pajisjet e zyres (EUR '000)	Pajisjet kompjuteri ke dhe software (EUR '000)	<u>Veturat</u> (EUR '000)	<b>Gjithsej</b> Prona, instalimet dhe pajisjet (EUR '000)
<b>Kostoja</b>					
Bilanci më 1 Janar 2001	380	58	584	44	1,066
Shtesë	55	20	113	28	216
Heqjet	—	—	—	—	—
Bilanci më 31 Dhjetor 2001	435	78	697	72	1,282
<b>AMORTIZIM I AKUMULUAR</b>					
Bilanci më 1 Janar 2001	59	6	263	4	332
Ngarkesa për periudhën	81	14	220	14	329
Heqjet	—	—	—	—	—
Bilanci më 31 Dhjetor 2001	140	20	483	18	661
<b>VLERA KONTABEL (NETO)</b>					
Bilanci më 31 Dhjetor 2002	<u>295</u>	<u>58</u>	<u>214</u>	<u>54</u>	<u>621</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2001	<u>321</u>	<u>52</u>	<u>321</u>	<u>40</u>	<u>734</u>

Shtesat në pronë, instalime dhe pajisje, më 31 dhjetor 2002, përfshijnë 216 mijëra EUR (31 Dhjetor 2001: EUR 244 mijë) në pronë, instalime dhe pajisje të blera nga fondi i granteve të pranuar nga Autoriteti Qendror Fiskal, USAID-i, Agjensioni Evropian për Rindërtim, Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Norvegjisë.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 6. AKTIVET TJERA VENDORE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
Të pranuar nga Autoriteti Qendror Fiskal (AQF)	-	305
Shpenzime të parapaguara	21	84
Tarifa nga liçencimi i bankave	15	-
Të pranuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER)	-	19
Aktivët tjerë	-	187
Të pranuar për pagesë të duplikuar	-	67
Stoqe të konsumueshme	<u>-</u>	<u>15</u>
<b>Gjithsej</b>	<b><u>36</u></b>	<b><u>677</u></b>

### 7. NGA BANKAT VENDORE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
Micro Enterprise Bank	13,319	9,508
Banka e Re e Kosovës	1,893	723
Banka Private e Biznesit	1,193	423
Banka Amerikane e Kosovës	2,350	-
Banka Ekonomike	584	88
Banka Kreditore e Prishtinës	450	-
Kasabanka	<u>518</u>	<u>-</u>
<b>Rez. e obliguar e likuiditetit gjithsej</b>	<b><u>20,307</u></b>	<b><u>10,742</u></b>
Micro Enterprise Bank	9,368	137,929
Banka e Re e Kosovës	7,875	33,595
Banka Private e Biznesit	2,659	15,236
Banka Amerikane e Kosovës	3,832	10,093
Banka Ekonomike	1,095	6,952
Banka Kreditore e Prishtinës	1,099	4,046
Kasabanka	<u>-</u>	<u>600</u>
<b>Llogaria rrjedhëse gjithsej</b>	<b><u>25,928</u></b>	<b><u>208,451</u></b>
<b>Gjithsej</b>	<b><u>46,235</u></b>	<b><u>219,193</u></b>

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 7. NGA BANKAT VENDORE (vazhdim)

Sipas Rregullores së Mbikëqyrjes së BPK-së, Rregulla nr. XVII, bankat komerciale që operojnë në Kosovë lypset të mbajnë rezerva të likuiditetit prej 10% të depozitave të klientëve gjithsej. Sëpaku, gjysma e këtyre bilanceve të rezervave duhet të mbahen në llogaritë e BPK-së. Disa bankave komerciale, më 31 dhjetor 2001, nuk u është kërkuar që të mbajnë një rezervë të tillë të likuiditetit, pasi që aktivitetet e tyre të mbledhjes së depozitave në atë kohë ishin ende të limituara.

Bilanci i rezervave, që tejkalon 5% dhe 10%, të depozitave të klientëve gjithsej sjell kamatë prej 1.25%, siq ishte më 31 Dhjetor 2002 (1.55%: më 31 Dhjetor 2001). Depozitat në llogaritë rrjedhese janë të ripagëshëm sipas kërkesës dhe nuk sjellin kamatë

### 8. NGA INSTITUCIONET QEVERTARE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
UNMIK	365	2,559
AQF: thesari, dogana, taksat dhe tatimet	258,753	69,536
UNMIK: ndërm. e shërbimeve publike	629	5,074
Nga qeveritë lokale komunale	494	2,369
Nga institucionet tjera qeveritare	<u>8,628</u>	<u>84</u>
<b>Gjithsej</b>	<u>268,869</u>	<u>79,622</u>

### 9. NGA ENTITETET PUBLIKE DHE KOMERCIALE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
Kompanitë e Sigurimeve	16,069	10,982
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	2,080	591
Ndërmarrja e Postës dhe Telekomunikimit të Kosovës (PTK)	761	1,255
Entitete jokomerciale (agjencionet humanitare dhe OJQ-të)	<u>416</u>	<u>1,657</u>
<b>Gjithsej</b>	<u>19,326</u>	<u>14,485</u>

Duke filluar prej korrikut 2002, llogaritë rrjedhese kanë siguruar norma të interesit që silleshin prej 1.25% deri në 1.75%, gjatë vitit. Norma e interesit e aplikueshme në llogaritë rrjedhese, më 31 Dhjetor 2002, ka qenë 1.25%.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 10. PASIVET TJERA VENDORE

	<u>31 Dhjetor 2002</u> (EUR '000)	<u>31 Dhjetor 2001</u> (EUR '000)
Ndaj Qeverisë	384	-
Kreditorëve të ndryshëm e përlogaritjeve	340	868
Llogarisë së pezulluar të transferit të jashtëm (shën. a)	-	20,857
Të hyrave nga grantet të shtyera (shën.b)	599	850
Ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës Kosovës (shën. c)	450	446
Pasive tjera vendore	<u>9</u>	<u>118</u>
<b>Gjithsej</b>	<b><u>1,782</u></b>	<b><u>23,139</u></b>

**Shënim a:** Shuma prej 20,857 mijëra EUR, më 31 Dhjetor 2002, ka të bëjë me transferin e pagesave në të mirë të klientëve të BPK-së që janë pastruar nga llogaritë e klientëve më 9 Janar 2002.

**Shënim b:**

	<u>AQF</u> (EUR '000)	Grante të AQF-së Euro konvertim (EUR '000)	<u>USAID</u> (EUR '000)	Bashkimi Evropian (EUR '000)	Qeveria e Norvegjisë (EUR '000)	<u>AER</u> (EUR '000)	<u>Gjithsej</u> (EUR '000)
<b>Të hyrat nga grantet, të shtyera, më 31 Dhjetor 2001</b>	332	204	40	95	65	114	850
Fondet e granteve të pranuar gjatë vitit	1,419	1,116	55	-	-	19	2,609
Transferta në të hyrat nga grantet	<u>(1,469)</u>	<u>(1,226)</u>	<u>(35)</u>	<u>(60)</u>	<u>(50)</u>	<u>(20)</u>	<u>(2,860)</u>
<b>Të hyrat nga grantet, të shtyera më 31 Dhjetor 2002</b>	<b><u>282</u></b>	<b><u>94</u></b>	<b><u>60</u></b>	<b><u>35</u></b>	<b><u>15</u></b>	<b><u>113</u></b>	<b><u>599</u></b>

**Shënim c:** Shuma lidhur me ish Bankën Popullore të Kosovës ka të bëjë me bilancin e parasë së gatshme në valuta të ndryshme që i takojnë këtij entiteti dhe të cilat qenë fizikisht prezente brenda kësaj Banke. Këto bilance janë konvertuar në DEM, më 22 Dhjetor 2000, ndërsa janë bartur fizikisht në Commerzbank AG në Frankfurt dhe përfshirë në bilancin e llogarisë rrjedhëse të BPK-së në këtë entitet.

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 11. FONDI LIGJOR

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/20 - "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës", kapitali i BPK-së në shumë 5.000, mijëra DEM (2.556 mijëra EUR) ishte kontribuar nga ana e Autoritetit Qendror Fiskal, më 31 Mars 2000.

### 12. FONDI REZERVE

Fondi reZervë është krijuar gjatë periudhës deri më 31 Dhjetor 2000 dhe në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/20 dhe vendimit të Bordit Drejtues të Bankës. Transferi i 3.437 mijëra EUR është bërë në vitin 2002.

### 13. TE HYRA TJERA NGA VEPRIMTARIA

	<b>Fundviti</b> <b><u>31 Dhjetor 2002</u></b> (EUR '000)	<b>Fundviti</b> <b><u>31 Dhjetor 2001</u></b> (EUR '000)
Tarifa nga liçencimi i bankave	346	80
Të hyra nga qiradhënia	16	19
Tjera	<u>7</u>	<u>26</u>
<b>Gjithsej</b>	<b><u>369</u></b>	<b><u>125</u></b>

### 14. FONDI REZERVE

Shpenzimet e personelit kanë të bëjë më së shumti me pagat e punëtorëve. Banka, më 31 Dhjetor 2002, kishte 132 punëtorë (31 Dhjetor 2001: 377 punëtorë)

## Shënime mbi Pasqyrat Financiare të BPK-së (vazhdim)

### 15. SHPENZIMET E PERGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

	<b>Fundviti</b> <b><u>31 Dhjetor 2002</u></b> (EUR '000)	<b>Fundviti</b> <b><u>31 Dhjetor 2001</u></b> (EUR '000)
Siguria dhe shpenzimet e transportit të parasë së gatshme	3,258	1,675
Shpenzimet për Euro konvertim	369	393
Riparimet dhe mirëmbajtja	176	188
Shpenzimet e auditimit dhe konsulencës	157	171
Shpenzime komunikimi (telefon, telex dhe internet)	152	82
